

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 175, Maj 2018
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

SHOQATA 2 ATDHETARE "DUKAGJINI" DOMOSDOSHMËRI E KOHËS

15 vjet ma parë u ligjërua, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", pra u zyrtarizua dhe filloj punën zyrtarisht. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" doli në skenën e kohës si domosdoshmëri për të mirën e komunitetit dukagjinas së pari, por edhe më gjerë, erdhi si vullnetarizëm dhe me përkushtim të pa parë ...

NJË PREZANTIM I 15 VJETORIT TË SHOQATËS ATDHETARE 3 "DUKAGJINI"

Në këtë festim morën pjesë anëtar, aktivist dhe veprimtar të Shoqatës, miq nga shoqatat analoge: Të shoqatës "Martin Dreshaj" me qendër në Pejë; të Ansambllit folklorik autokton "Rugova"; të Muzeut "Ivezaj" në Tuz; Klubi i Shkrimtareve në Kline; shoqata "Bytyçi-Tirane - Prizren"; shoqata "Sali Mani"; shoqata ...



SHOQATA ATDHETARE “DUKAGJINI” DOMOSDOSHMERI E KOHËS

- PËRSHËNDETJE -

15 vjet ma parë u ligjërta, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, pra u zyrtarizua dhe filloj punën zyrtarisht.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” doli në skenën e kohës si domosdoshmëri për të mirën e komunitetit dukagjinës së pari, por edhe më gjerë, erdhi si vullnetarizëm dhe me përkushtim të pa parë askund ndër shoqata, madje as edhe në shumë zyra apo përsone zyrtarë deri në sot, për të zbuluar dhe rizbuluar historinë dhe kulturën, natyrën dhe etnografinë, zhvillimin dhe përparimin me arritjet, dobësit, moskujdesin, apo kokëçarjet e moskokçarjet e kohës dhe përsoneve politiko-shtetëror, për ta “rizgjuar historinë e kësaj krahine”, siç thotë një mik i shoqatës tonë.

Shoqata jonë nuk u ngrit në truall të shkretë, nuk u ngrit në boshllëk, por ishte një përvojë me rëndësi në këto troje. Në të gjitha kohët edhe malësorët dukagjinës ditën të organizohen në marrëdhëniet e bashkëjetesës midis tyre, për në kuvende, për punë, për të shkuar në luftë, për tu mbrojtur, për t’ju përgjigjur kushtimit të fisit, krahinës dhe vendit, për të jetuar. U bënë përpjekje për krijimin e një bashkimi vullnetar, si kjo që kemi sot ose afërsisht si kjo, që nga fillimi i viteve 2000, por duket se nuk u arrit bindja e duhur për atë që ku, si dhe çfarë duhej. Pra pati disa vështirësi objektive por edhe subjektive që e zgjatën deri në vitin 2002, kohë kur po merrte rrugë, po përvijohesh, organizimi i një grupimi që do të bëhej promotori i ri zgjimit të historisë së kësaj krahinë.

Në vjeshtën e vitit 2002, më në fund, u formësua “grupi nismëtar”, i cili menjëherë filloj nga puna për përgatitjen e dokumenteve bazë të shoqatës, pra statuti dhe programi i shoqatës. Projektin e Programit të punës e mori përsipër Ndue Sanaj, ndërsa statutin unë (Luigj Shyti). Këto do të paraqiteshin për dy-tre javë në mbledhjen e grupit nismëtar. Nuk kishim struktura drejtuese, por mendimet ishin konvergjente në shërbim të nismës. Një element shumë i rëndësishëm dhe që vërtetë kështu rezultoi, qe vendimi unanim që asnjëri në punën e shoqatës të mos kishte asnjë përfitim material. Çdo gjë në punën me shoqatën dhe gazetën e saj, të ishte vetëm vullnetare.

Që në statutin e parë të shoqatës, të cilin e ruaj në dorëshkrim si një replikë të bukur e interesante, dhe në programin e saj u shkrua puna vullnetare në shoqatë dhe mundësia e botimit të një gazetë, dhe menjëherë u vumë në punë.

Ishin bërë përpjekje për daljen e një gazete që në verën e vitit 1996, duke kërkuar edhe ndihmën e shoqatës turistike SNV nga Holanda, që drejtohej nga Xhoni (mbiemrin nuk ja kujtoj) dhe vepronte në Theth. Pothuaj ramë dakord që të realizohej, por problemet politike-shoqërore ndryshuan vullshëm në gjysmën e dytë të atij viti dhe në vitin

1997. Ai u largua nga Shqipëria dhe mbeti pa u realizua. Ai na pati premtuar ndihmë edhe në organizim, por edhe në fonde që të dilte, ndonëse u krijua një ide edhe për titullin e saj dhe konkretisht “Djelmnia”, ndonëse nuk vendosëm. Patëm biseduar edhe me drejtuesit e kohës në Komunën



Shalë dhe nuk qemë larg krijimit të ndonjë mundësie, por gjerat shkuan si shkuan.

Në çdo punë a veprimtari është dikush që kujtohet, është dikush që i shkon mendja pak përpara të tjerëve. Edhe në themelimin e shoqatës tonë është dikush që i thirri dikujt, është një grup që ishte nismëtar i cili filloj nga puna përgatitore, të paktën, që në gjysmën e dytë të vitit 2002. Nuk po analizojmë këtu se kush i thirri shoqit, si u përgjigji ai, çfarë u bë sepse pikërisht në këtë moment, sepse mbase do ti vij koha edhe kësaj. Grupi nismëtar, renditur këtu sipas rendit alfabetik, i përbërë nga Fran Kapaj, Fran Preçi, Luigj Shyti, Martin Arra, Ndue Sanaj, Ndue Vata, Pal Lera dhe Prelë Shytani u duhet njohur e vlerësuar veprimtaria e tyre, e cila doli e suksesshme në vitet që pasuan, dhe tregoi se themelimi i kësaj shoqate ishte domosdoshmëri për Dukagjinin dhe komunitetin e tij, kudo që janë. Këta ishin ata që ndezën “llambën e shpresës” për të ndriçuar vendlindjen për të parë më mirë veten dhe për tu parë nga të tjerët me qartë, jo vetëm bardh e zi po me ngjyrat e jetës, historisë e kulturës tonë. Natyrisht këtu u bashkuan intelektual, gazetar, specialist të fushave të ndryshme, të gjithë me dëshirë e mendim për të bërë më të mirën e mundshme, dhe që u bënë bashkudhëtarë dhe bashkëluftëtarë për realizimin e programit të shoqatës tonë.

Puna e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” qe e mirë organizuar, e mirë informuar dhe e mirë menaxhuar, duhej edhe

komponenti i mire financimit, por këtë e gjetëm në zemrën dhe xhepin tuaj të dashur dukagjinës dhe dashamirë të Dukagjinit.

Në kryesinë e shoqatës pati vetëdisiplinë të fortë në diskutimet, ballafaqimet dhe marrjen e vendimeve së pari me

përfshirës.

Nuk është njëllëj si ta shikosh punën dhe problemet nga larg, nga jashtë, si të jesh brenda, sepse nga brenda shikohen shumë elementë që nuk shikohen nga jashtë, nuk është njëllëj si të rrih duke thënë, “...do të..., ...duhet..., me atë “...do ta bëjmë...”, “...do të bëj...”, “...ta bëjmë bashkë...”, etj. Por nganjëherë, dhe jo radhë, ndoll si me atë artizanin që nuk ka mundur kurrë të qepë një xhubletë dhe kurrë nuk len xhubletë pa fjalë.

Kur kontribuon dhe len gjurmë pozitive është vepër e madhe. Në kështu bëme, dhe kështu ndodhi.

Për ne të gjithë duhet të jenë e qartë se Dukagjini, emri i tij, vendi, toka me shtëpi e varret e të parëve, me bëmat e tyre të mira, është e përhershme, ne, njerëzit, jemi të përkohshëm. Për ne, dhe të gjithë komunitetin, duhet të jenë e qartë dhe të punojmë që të mbetët e përhershme, pra Dukagjini, Shqipëria, sepse brenda tyre jemi edhe ne.

Ne kemi bërë përparime mjaft të mëdha, por edhe me shumë duhet të emancipohemi, veçanërisht rinia, brezi i ri i sotëm dhe ata që vinë. Jo çdo gjë që shkëlqen është ar. Interneti, rrjetet sociale janë të mira, por nëpër to ka shumë jo të mira, e që paraqiten si të mira. Kjo duhet parë me shumë kujdes. Asgjë nuk e zëvendëson librin, mësuesin, edukatën e mirë familjare, edukatën e mirë shoqërore. Po të mos vlerësohen këto, pasojat do të jenë shumë të mëdha.

Dukagjini ka jo vetëm nevojën, por domosdoshmërinë për njerëzit e tij të mirë dhe të interesuar. Nuk i duhen ata që mohojnë çdo gjë pa analizë, pa diskutim, në një formë apo një tjetër, ata që refuzojnë prejardhjen, rrënjën, nga Dukagjini. Dukagjini e ka domosdoshmëri punën dhe përkrahjen e të gjithë dukagjinësve, pa mëdyshje edhe të tjerëve, miq e dashamirë të Dukagjinit dhe dukagjinësve kudo që ndodhen, sepse kjo na ka sjellë deri këtu, e kjo do të çojë përpara punën, edukimin, emancipimin dhe kulturën tonë të mirë, historinë dhe të ardhmen e brezave që vinë. Secili nga ne dukagjinësit, sido që të bëhet, një ditë do të kemi nevojën për Dukagjinin, për rrënjët e tona, për prejardhjen e tonë.

Edhe në punën tonë, por, dhe në jetën e përditshme na shfaqet koncepti si “këtë e kam pasur nxënës”, “... e kam pasur vartës...”, “...e kam pasur ushtar”, “... e kam marrë në punë”, etj. e që të gjitha këto kanë një farë diskriminimi me “ëmbëlsi”. Po, mund të jenë të gjitha të vërteta, por kurrë nuk duhet harruar se njerëzit nuk mbetën gjithmonë të vegjël, nuk mbeten gjithmonë fëmijë, puna e secilit ushtar, vartës, shërbëtorë, punëtorë të thjeshtë, etj. Njerëzit ngjiten shkallët, dikush ma shpejt e dikush ma ngadalë, dikush mbetet n vend. (vijon në faqen 5)

mirëkuptim.

Kemi bërë shumë veprimtari kulturore-artistike, kemi bërë studime shumë të vlefshme dhe konferenca e sesione shkencore, kemi marrë pjesë aktive në debate e diskutime, në veçanti kur janë trajtuar nga ato që i përkasin komunitetit tonë, por edhe më gjerë. Kemi vlerësuar afër 500 përsone, gra e burra, të rinjë e të moshuar, brenda dhe jashtë atdheut, edhe të huaj, kemi njohur publikuar dhe vlerësuar luftëtarë të kohëve të ndryshme, të cilët kanë dhënë jetën për tokën tonë, për Shqipërinë. Kemi vlerësuar intelektual të kohëve të ndryshme, punëtorë, arsimtarë, artizan, këngëtarë e instrumentist popullor, mjeshtër në fusha të ndryshme, humorist e punonjës kulture, etj. etj.

Gazeta “Dukagjini” ka qenë dhe është një publikuese, një lajmëtare, një promovuese e punës së shoqatës, kërkesave dhe nevojave të komunitetit tonë, por edhe më gjerë. Kjo është domosdoshmëri që të vijohet. Është e vetmja gazetë që del në Shkodër që prej 15 vjetësh, rregullisht në çdo muaj.

Shoqata dhe gazeta nuk u bunkerizuan, as nuk u privatizuan, as nuk u personalizuar dhe sa nuk u përfshinë në politikën partiake. Ne nuk u përpoqëm ta quanim veten viktimitë, por as të bënim heroin. U përpoqëm që të kërkonim atë që na takon.

Patëm edhe vështirësi, pse jo me mëlmese kriptodemokratikosocialistokomunistoushtarakopolicore. Kjo nuk na dekurajoi, por na bëri më punëtorë, më këmbëngulës, më të hapur, më gjithë

NJË PREZANTIM I 15 VJETORIT TË SHOQATËS ATDHETARE “DUKAGJINI”

Anëtar e anëtare, aktivist e veprimtar të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”!

Miq e mike të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”!

Kryesia e Shoqatës, me datën 13 maj 2018, në mjediset e Fshatit të Paqës festoi 15 vjetorin e Themelimit të saj.

Në këtë festim morën pjesë anëtar, aktivist dhe veprimtar të Shoqatës, miq nga shoqatat analoge: Të shoqatës “Martin Dreshaj” me qendër në Peje; të Ansambllit folklorik autokton “Rugova”; të Muzeut “Ivezaj” në Tuz; Klubi i Shkrimtareve në Kline; shoqata “Bytyçi-Tirane – Prizren”; shoqata “Sali Mani”; shoqata kulturore e atdhetare “Postriba” dhe të teatrit “Aleksandër Moisiu” në Peje.

Pas disa sekuencave filmime, nëpërmjet të cilave u paraqit me figure jeta 15 vjeçare e shoqatës të paraqitur nga Luigj Mila dhe të këngës të grupit “Treva” “Dukagjini Nderi i Kombit”, të kënduar nga kantautori Fran Kodra e këngëtari Ndue Shytani, Sekretari i Shoqatës, zoti Luigj Shyti mbajtiti fjalën e rastit, duke prezantuar jetën e 15 viteve të Shoqatës, që në mes të tjerave theksoj, se çelësi i arritjeve në këto 15 vite ka qene, është dhe duhet të jete idealizimi për ti shërbyer vendit tënd, vullnetarizmi, duke cituar thënien e Shën Terezës, duhet punuar nga pak, por me dashuri. Dhe ne punuam nga pak, pa u ndalur asnjëherë, duke pasur të qarte misionin e shoqatës në punën tone, me moton: “Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por pyet, se çfarë unë bëra për Dukagjinin”.

Pastaj kaluan në koncert, me valle nga grupi Rugova, me lahutarin Hysen Kurtaj, valltaret e koreografit Aldo Nika, këngëtari Pëllumb Vatnikaj, grupi Ndue Shytani, Viola Shqau, Anila Kodra e Fran Kodra dhe në mbyllje me këngëtarin Pëllumb Vrinca, të cilët i falënderoj për kontributin e tyre në këtë 15 vjetor,

Në këtë përvjetor me vendim të kryesisë u nderuan me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, Imzot Monsinor Angelo Massafra, zotin Flamar Gashi, zoti Arben Gjuraj dhe zonjën Prenda Mark Shpendi; me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, zotin Petro Koçi dhe zotin Kole Çardakun; me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”, zotin Tonin Vasa; me titullin “Medalioni Mehmet Shpendi”, Tulan Lulashi dhe Martin Gjon Gilaj, pas vdekjes; me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, Ministrinë e Kulturës, Fadil Galiqi, Dukate Bregu, Besim Zagani, Nikoll Hebja e Lek Mirash Nika – pas vdekjes, Sose Nika Shqau, Kin Kola, Simon Zhuri, Marie Buxha dhe Drita Zef.

Në këtë ceremoni festive, përshëndeten: Drejtori i Ansambllit “Rugova”, zoti Vesel Nikçi, i cili në emër të këtij ansambli dorëzoi titullin “Mirënjohja” për shoqatën, për kryetarin e shoqatës-Ndue Sanaj dhe për Zef Lualsh Sokolin, pas vdekjes; Klubi i Shkrimtareve në Kline, zoti Prend Buzhala dhe zoti Ismet Krasniqi-Lala, të cilët nderuan me titullin “Mirënjohja”



kryetarin e Shoqatës, Ndue Sanaj; zoti Rrahman Jashari përshëndeti në emër të Shoqatës “Martin Dreshaj” dhe zoti Ukshin shoqatës i dhe titullin “Mirënjohja”; zoti Fadil Grabovci, përshëndeti në emër të Teatrit “Aleksandër Moisiu” dhe nderoj me titullin “Mirënjohja” shoqatën; përshëndeti zoti Shtjefen Ivezaj, në emër të Muzeut “Ivezaj” dhe nderoj shoqatën me titullin “Mirënjohja” dhe Agron Isa Gjedi, përshëndeti në emër të shoqatës “BYtyçi”-Tirane-Prizren dhe kryetarin e shoqatës, Ndue Sanaj e nderoj me çmimin “Plisi i bardhë emblema hyjnorë e shqipëtarisë”, i klasit të parë..

Pas pjesës së parë të festimit në salle, pjesëmarrësit dolën jashtë, në natyrë që ndoqën prezantimin e veshjeve tradicionale nën drejtimin e zotit Gjon Dukgilaj.

Festimi i 15 vjetorit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” u mundësua nga dukagjinasi Prek Gjonaj, Sokol Strebçyçi, Vito Sanaj, Mhill Ftoni, Nikoll Gerla, Mhill Bregu, Ndoc Bregu, Luigj Ladinaj, Anton Kosteri, Arber Raja, Edmond Terthorja, Roza Pjetri, File Strugaçi, Kole Çardaku, Gëzim Çardaku, Gjergj Leqejza e Gjon Dukgilaj. I falënderojmë për kontributin e tyre! Mirënjohje për kontributin e tyre!

Gjate këtyre viteve nuk janë pak arritje, nder të cilat më kryesoret janë:

1- Janë përgatitur dhe zhvilluar konferenca, simpoziume dhe seminare shkencore, nën temën e përgjithshme “Dukagjini në rrjedhat e historisë”

*Kuvendet Malësore dhe koha, në 85 vjetorit të Besës së Prekalit”

*Traditat patriotike dhe liri-dashëse të dukagjinase në vitet 1890 - 1920, me rastin e 95 vjetorit i Luftës së Qafës së Agrit, 90 vjetorit të Përballjes së Madhe të Planit dhe rënies së 81 dëshmorëve, midis të cilëve edhe trimi i pamposhtur i Dukagjinit, Mehmet Shpendi.

*Një misionar në Shërbim të Kombit”, kushtuar një figure të madhe të Dukagjinit dhe të Shqipërisë, At’ Jak Marleka (prof. dr. Luigj Marleka) 100 vjetorit të lindje

*Kultura materiale e shpirtërore në Dukagjin, kushtuar vlerave materiale dhe shpirtërore të dukagjinase dhe Dukagjinit.

*Femra dukagjinase dhe koha, kushtuar jetës, përkushtimit dhe punës femrës dukagjinase.

*Gjakmarrja retorike apo realitet”, kushtuar gjakmarrjes, në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe

*Konferencë përkujtimore, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim

me shoqatën Kosovë Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Peje

*Drejtimet e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit, seminar

*100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin, Konferenca shkencore, me rastin e njëqindvjetorit të fillimit të hapjes së shkollave në Dukagjin.

2- Përgatite dhe nxjerre çdo muaj, duke filluar nga muaji dhjetor 2003, gazetën “Dukagjini”, botim i shoqatës, dhe në muajin maj te këtij viti del numri 175.

3- Janë promovuar 68 libra të autoreve dukagjinase, që kanë shkruar kryesisht dukagjinasi për Dukagjinin

4- Përgatitur dhe zhvilluar 67 veprimtari kulturore e artistike në bashkëpunim me shoqata analoge, si “Martin Dreshaj”, Grupin artistik “Treva”, “Dede Gjon Luli”, Qendrën e Gruas “Hapat e Lehtë”, Muzeun “Ivezaj” në Tuz e të tjera. Një nga veprimtaritë kulturore e artistike u zhvillua me datën 6 deri me 10 prill te këtij viti, me Shoqatat “Martin Dreshaj”; Ansambli Folklorik Autokton “Rugova”, Shoqatën “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit” dhe atë kulturore “Sali Mani”, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, Manifestimi, i pagëzuar “Zëri i Vëllazërimit-2018”.

5- Gjate këtyre ka qene një arritje e madhe dekorimi i figurave me kryesore te Dukagjinit, si: me urdhrin “Nderi i Kombit” atdhetari Mehmet Shpendi, albanologu Martin Camaj, piktori Lin Delija dhe Profesor Kole Prela; dekorimi i poetit Frederik Rreshpja me urdhrin “Mjeshtër i Madhe”

6- Arritje e jashtëzakonshme e Shoqatës “Atdhetare Dukagjini” dhe mbështetësve të saj, ka qenë vendosja e shtatoreve të atdhetarit Mehmet Shpendit dhe albanologut Martin Camaj në qytetin e Shkodrës, dhe kulmore e të gjithë veprimtarive në historinë e kësaj shoqate ka qenë datën 23 mars 2017, kur në mjediset e Presidencës, u zhvillua ceremonia nga Presidenti i Republikës Z. Bujar Nishani, e dekorimit të zonës së Dukagjinit, me Urdhrin e lartë “**NDERI I KOMBIT**”.

7-Shoqata Atdhetare “Dukagjini” është anëtare themeluese të klubit “Media e Shkruar”, të Veprimit Lokal “Bjeshkët e Namuna” dhe të grupit “Shpresa për Jetën”.

8-Në këto 15 vite, Kryesia e shoqatës ka nderuar me tituj Nderi 507 persona, në mes tyre 56 femra.

Me titullin “Diplome Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 14 persona;

me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 133 persona;

me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 52 persona; në mes tyre Monsinor Angelo Massafra;

me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 15 persona;

me “Medaljonin e Logut të Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 7 persona, në mes tyre Gjeneralin Eesley Clark, Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Harajdni dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë, zotin Bujar Nishani;

me titullin “Peneli Dukagjinasi”, në mes tyre Pikturin e Merituar Zef Shoshi dhe Mjeshterin e Madh, Ndoc Gurashi;

me titullin “10 vjetori i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” - 33 persona;

me titullin “Mirënjohja Martin Camaj” - 20 persona;

me titullin “Medalioni Mehmet Shpendi” - 15 persona;

dhe me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin” - 200 persona.

Në të gjitha këto arritje është përkushtimi i anëtarëve të Shoqatës, aktivisteve e veprimtareve, miqve e mikeve të saj, por në mënyrë të veçante: të N/Kryetarit të saj-Gjergj Leqejza; të Sekretarit të saj-Luigj Shyti; të anëtarëve të kryesisë Mhill Prroni, Roza Pjetri, Prele Milani, Dukate Bregu, Lazer Kodra e Marinela Buxha, Mri Kroj, Pale Lera, Anton Kosteri, Zef Bari, Syka Çarku; të Kryetarit të Këshillit të Shoqatës - Prele Shytani e sekretarit të tij, Aleks Dushi; të anëtarëve të këshillit të shoqatës Agron Hasanaj, Ndue Mici, Kole Çardaku e Luigj Mila; veprimtareve Gjon Kosteri, Lulash Brigja, Martin Martini, Diana Bungu, File Strugaçi, Zef Lulash Sokoli, Luigj Martini, Ndoc Bjeshka e shumë e shumë të tjerëve. Të gjithë i falënderojmë për punën që kanë bere në shërb-

im të realizimit të misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Të gjithë këto arritje nuk janë realizuar pa mbështetjen financiare të mjaft mundësorëve dukagjinasi, të cilët nuk janë pak, plote 126 mundësorë, që kanë dhënë me shume dashuri nga 500 leke dhe deri në 1 444 913 leke, gjithsej 6 930 256 leke në këto 15 vite.

Ata janë: Arbër Raja, Agim Gilaj, Agron Hasanaj, Amerika B3P, Armir Grimaj, Anton Kosteri, Bardhok Zhuri, Bal Vuksani, Banka Credins, Besim Hoxha, Bujar Kodra, Dede Toka, Daniel Kopsaj, Dega e Kurbinut, Dega e Tiranës, Dede Fusha, Edmond Tërthorja, Engjëll Radohima, Fran Vuksani, Fran Sukani, Fran Preçi, Gjin Brigja, Gjon Fierza, Gjon Shtylla, Gjergj Prioni, Gjovalin Shyti, Gjovalin Kodra, Gjergj Leqejza, Gjeloš Musa, Gjin Kodra, Gjin Zhuja, Gjergj Vocaj, Gjin Mekshi, Gjek Sokoli, Gjon Dukgilaj, Hil Kodra, Kin Pisha, Kole Çardaku, Kompania e Sigurimeve "Dukagjini", Kuotat, Komuna e Rrethinave, Karlo Marleka, Kole Tonaj, Kole Funiçi, Kujtim Prioni,

Keti Bazhdari, Luigj Shyti, Lulash Gjelošhi, Lazer Kodra, Luigj Mila, Leke Sokoli, Luigj Ladhinaj, Martin Cubi, Mark Zhuri, Mhill Shkalla, Mri Kroj, Marash Plepi, Mirash Mici, Mhill Prioni, Mir Bobi Ziçi, Mark Kroqi, Martin Selimi, Mark Rupa, Mirjana Sinani, Meritan Spahija, Mitër Ndreshaj, Mark P. Kulla, Ministria e Kulturës, Martin Martini, Mirela Gjoni, Mhill Ftoni, Mhill Bregu, Ndoc Bregu, Nikoll Gerla, Ndue Sanaj, Nike Tom Gjona, Nikolin Dedvukaj, Nosh Vuksani, Ndoc Piniqi, Ndue Marashaj, Ndreka Guri, Ndue Mici, Ndue Shurlaj, Nike (Zef) Mrina, Ndoc Bjeshka, Ndue Ftoni, Nikoll Vocaj, Ndoc Çardaku, Pëllumb Shqau, Pal Lera, Pjesëmarrësit, Pal Gjola, Pal Troshani, Pëllumb Kulla, Prele Çardaku, Pjeter Gjeta, Pjeter Gera, Prele Milani, Preke Toma, Prele Shytani, Preke Tom Gjona, Prenda Shpendi, Qendra e Gruas "Hapat e Lehta", Roza Pjetri, Sokol Sterbyqi, Silvana Arrinaj, Syka Çarku, SIGMA, Shoqata e te Drejtave të Njeriut, Shitja e gazetës, Tonin Kamberi, Tonin Gjoni, Tom Arra, Tonin Gjona, Tom Shpendi, Tome Ndoka, Tonin Marku, Vito Sanaj, Vate Musa, Vasfi Duka, Voc Deda, Vaso Shkoza, Zef Kripsi, Zef Shoshi, Zef Gjeta, Zef Gjergj Nika dhe Zef Nika. Të gjithë i falënderojmë dhe i urojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Ndërsa për ndërtimin dhe vendosjen e monumentit të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe të albanologut Martin Camaj, kanë kontribuar financiarisht dukagjinasi kudo ndodhur.

Nga Nju-Jorku, 77 vete, me shumën 52 500 \$, duke mbuluar 62 % e buxhetit: Alban Kaçaj, Agim Marku, Arjanit Simoni, Agim Kole Shkambi, Broz Shllaku, Boris Fran V. Shalanin, Dede Prendaj, Daniel Previzi, Dod Preçi Curanaj, Erland Lisi, Familja e Kol Mirit Dedevukaj, Familja Tonaj, Familja e Kol Nolit Gjela, Familja e Gjergj Vocrit, Familja e Nik Marashit, Fran Frashnishta, Gjelošh Kola, Gjeto Bregu, Gjin Radohina,

Gjovalin Kroni, Gjon Sokol Gjela, Gjin Markaj, Gjon Baftia me Familje, Gjergj Ndoja Vataj, Hil Krasniqi, Jozef Gjergj V. Shalanin, Kole Camaj, Kujtim Funiçi, Kujtim Mali, Lin Kumbulla, Luçian Kiri, Leëis Nika Gjela, Luk Toma Smajla, Luc Gjonlekaj, Martin Shpendi Gjela, Marjan Preçi, Mark Mici, Mark Dreni, Mirash Noli Gjela, Mark Rroku Gjela, Marash Kol Vuksanaj, Mark Gjelošhi Mirakaj, Mark Lushi Shalanin, Martin Leka,



Ndoc Zefi Simolacaj, Nikoll Nikgjonaj, Ndue Pal Luli, Nush Noli Gjela, Ndoc Sukaj, Nikoll Llesh Vuksanaj, Nua Kola Shalanin, Nik Gjergji Gjela, Nike Çarku, Ndue Slora, Pashko Llesh Vuksanaj, Pellumb Çekaj, Pal Noli Gjela, Pal Balbona, Paulin Troshani, Pjeter Llesh Vuksanaj, Petrit Nika, Paulin Lufaj me Vllazën, Prel Balbona, Gilbert Radohina, Petrit Nika, Pal Krasniqi, Sokol Kukaj, Sokol Smajli, Sokol Kodra, Simon Zefi Simolacaj, Shuk Balbona, Tom Balbona, Tom Rrethaj, Tom Shabi, Vat Biga, Vladimir Lpeja, Zef Gjoku Gjela.

Nga Miçigani 66 vete, me shumën 9 400 \$ dh 300 000 leke: Arben Sokoli, Alfons Grishaj, Albe Çulaj, Artan Gjoka, Agostin Çupi, Angjelin Ndou, Ben Pellumbja, Dede Beleshi, Eduard Aliko, Fran Gjokaj, Fran Marku, Gëzim [Gjergj] Plepi, Gjovalin Gjela, Gjovalin Kaçori, Gjin Piroli, Gjon Marku, Gjok Gojani, Gjozef Dedvukaj, Gjovalin Gega, Gjergj Jaku-Kosove, Gjovalin Gega, Gjok Grishaj, Gjek Gjela, Jetmir Dedaj, Jetmir Cigarja, Juljan Çefa, Kol Kroj, Kujtim Qafa, Kujtim Sterbyqi, Kujtim Pren-di, Kel Popa, Kujtim Sterbyqi, Leke Oroshi, Lek Leci, Luigj Gjoka, Luvigj Sterbyqi, Luçiana Ftoni, Mark Shkreli, Marjan Kolaj, Martin Leka, Nikolin Shyti, Ndue Ftoni, Nikolin Shyti, Nik Zef Laloshi, Nike Goxhaj, Ndue Duhani, Ndreka Lulashi, Nikoll Hysaj, Prel Marku, Petrit Sokoli, Pellumb Kulla, Pashko Gjokaj, Paulin Gega, Peti Camaj, Pjeter Jaku, Pjeter Stanaj, Pal Shkreli, Prel Popa, Rita Gjela, Rush Dragu, Shkelqim Suka, Tun Musolli, Tush Duhani, Vangjel Shyti, Viktor Milani e Malësia e Madhe.

Nga Belgjika, 13 vete, me shumën 1 500 €: Altin Preka, Fran Stomiçi, Florian Stomiçi, Leke Gilaj, Lulash Piniqi, Mark Çuni, Nol Stani, Prele Mraja, Sokol Ara, Sadik Kapaj, Tonin Çardaku, Vate Sokoli, Valentin Mici, Vate Musa...

Nga Shqipëria, 25 vete, me shumën 837 000 leke, 730 \$ dhe 5 940 € :

Arjan Gjura, Alfred Haxhari, Bardhok Braçi, Gjon Broçulla, Gjon Gilaj, Gjovalin Kroni, Fran Molla, Fran e Preke Preçi, Familja Gjon Doda (Lad Gjoni), Fran Piniqi, Kole Çardaku, Martin Martini, Ndue Mhill Çardaku, Ndoc Selimi, Ndue Sanaj, Ndoc Marku, Prele Milani, Preke Gilaj, Prenda Mark Shpendi, Tome Shpendi, Viola Shqau, Viktor Cukeli, Vladimir Shyti, Vuksan Kola, Zef Lulash Sokoli.

së redaksisë. E theksoj këtë, se kohët e fundit ka zëra, se unë jam themeluesi i gazetës, se unë jam themeluesi i kësaj apo asaj statutit, se unë jam themeluesi i programit. Patjetër, se dikush i ka shkruar, ashtu siç ka shkruar diskutimet e vendimet e strukturave vendimmarrëse mbajtësi apo mbajtësit e protokollit, por ata nuk kanë autorësi.

Të gjitha këto që theksova më sipër janë miratuar në Konferencën e Parë të Shoqatës zhvilluar punimet e saj me 6 prill 2003 dhe vetëm ajo është autorësia e tyre.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mbushi plote 15 vite pune të pa ndalur, në shërbim të zonës së Dukagjinit e dukagjinasi, kryesisht në fushën e historisë dhe të kulturës. Kjo përvojë 15 vjeçare, tregon se Dukagjini e dukagjinasi duhet të kenë shoqatën e tyre, që punon dhe kjo shoqatë duhet të eci pa u ndalur.

Njoftoj anëtarët e shoqatës, se me 15 shtator 2018, dite e shtune, në mjedisin e bibliotekës "Luigj Gurakuqi" do të zhvillojë Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës për zgjedhjen e strukturave drejtuese të Saj, Kryetarit e Shoqatës dhe anëtarët e Këshillit të Shoqatës. Këshilli i Shoqatës do të zgjidh kryetarin e sekretarin e Këshillit dhe anëtarët e Kryesisë së Shoqatës. Pas kësaj Kryesia e Shoqatës cakton N/Kryetarit Sekretarin dhe kryetaret e seksioneve të shoqatës, si dhe Kryeredaktorin e gazetës.

Me këtë rast ftoj dukagjinasi kudo janë të bëhen anëtar të shoqatës brenda muajit gusht 2018, në veçanti të afrohen të rinj e të reja, student e studente. Bëjmë thirrje kryesisht të rinjve, se MISSIONI i shoqatës duhet të ndryshohet dhe mendojmë, se afërisht duhet të jetë: "Puna dhe përpjekjet që duhen bërë për emancipimin shoqëror të dukagjinasi kudo janë, duke bërë përpjekje të largohemi nga mendësitë orientale, që jo në pak raste na kanë lanë dhe po vijojnë të lejnë prapa njohjes të detyrave të qytetarit për të ecur përpara drejtë standardeve evropiane".

Këto zgjidhje do të zhvillohen nga larte poshtë, me qëllim që strukturat vendimmarrëse të çojnë frymën e tyre në zgjidhjet nëpër degët e saj. Ftoj anëtarët e anëtarët e Shoqatës të paraqesin kandidaturat përkatëse për tu bërë pjesë konkurruese në të gjitha nivelet vendimmarrëse të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", brenda muajit gusht 2018.

Gjithashtu ftoj anëtar e jo anëtar, miq e mike të shoqatës të japin mendime për strukturat e shoqatës, për misionin e Shoqatës në të ardhmen, për përmbytjen e gazetës "Dukagjini" dhe të tjera brenda muajit gusht 2018, të cilat do të përpunohen nga grupi i punës, i cili do të paraqes Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës, e cila ka të drejtën vendimmarrëse në nivelin më të lartë të Shoqatës.

Gjithashtu ftoj anëtar e jo anëtar, miq e mike të shoqatës të japin mendime për strukturat e shoqatës, për misionin e Shoqatës në të ardhmen, për përmbytjen e gazetës "Dukagjini" dhe të tjera brenda muajit gusht 2018, të cilat do të përpunohen nga grupi i punës, i cili do të paraqes Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës, e cila ka të drejtën vendimmarrëse në nivelin më të lartë të Shoqatës.

Gjithashtu ftoj anëtar e jo anëtar, miq e mike të shoqatës të japin mendime për strukturat e shoqatës, për misionin e Shoqatës në të ardhmen, për përmbytjen e gazetës "Dukagjini" dhe të tjera brenda muajit gusht 2018, të cilat do të përpunohen nga grupi i punës, i cili do të paraqes Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës, e cila ka të drejtën vendimmarrëse në nivelin më të lartë të Shoqatës.

NDUE SANAJ
KRYETARI

SHOQATA ATDHETARE “DUKAGJINI” DOMOSDOSHMERI E KOHËS

(vijon nga faqe 2)

Çdo kush mund të thotë apo të shkruaj sipas mendjes së tij, por nuk mund të zhbëjë punën e përpjekjet e kolegëve, të tjerëve. Ajo që të vlerëson është puna, studimi, kërkimi, mendimi, arsytimi lodhja në shërbim të punës. Pavarësisht mendimit personal e të njëanshëm, që shfaqet ndonjë herë, nuk duhet të mos vlerësohet apo fshirë puna e secilit në arrijtjen e rezultateve të shoqatës, apo edhe kudo tjetër. Këtë e kemi pasur dhe duhet ta kemi parasysh në punën tonë, sepse për shoqatën tonë, kryesinë, veprimtarët, studiuesit, lektorët apo bashkëpunëtorët, kjo është i vetmi shpërblim për ata që punuan dhe punojnë personalisht dhe kolektivisht.

Ne, dukagjinast, pse jo edhe mjaft më gjerë, kemi pasur, por dhe kemi pamundësi, dhe kjo na ka krijuar dhimbje. Nuk mund dhe nuk duhet të paragjykohe ai që nuk ka pasur mundësin të duket, të jap atë çfarë di, të provohet. Kur nuk ke mundësi nuk mund të punosh, nuk mund të ndihmosh, nuk mund të prodhosh, nuk mund të dashurosh, nuk mund të lindësh, nuk mund të ecësh, nuk mund të përballosh, nuk mund të mësosh dhe përgatitesh për jetën. Kjo kërkon më shumë pjesëmarrje nga vetë komuniteti ynë, më shumë veprimtari publike, që të shikohe mi, të vlerësohemi, pse jo edhe të rrezikojmë ndonjëherë, sepse pa këto nuk arrihet atje ku duam. Duhet të jemi edhe ne në rrugëtimin e shoqërisë tonë, në rreshtin e parë, në tavolinë, në drejtim, në karrige, në kuvende, etj.

Shoqata dhe gazeta e saj janë domosdoshmëri për Dukagjinin dhe shoqërinë, prandaj duhet ruajtur dhe çuar më tej.

Për shoqatën tonë dhe kryesinë e saj, gjithmonë, i pari, në qendër të vëmendjes, dhe mbi gjithçka ka qenë Dukagjini dhe dukagjinast kudo që janë, po, natyrisht, edhe interesat e kombëtare, me ato mundësi që kishim dhe kemi. Për këtë shoqatë, Dukagjini, ishte partia e vetme për të cilën punuam me mend dhe me zemër, dhe për këtë jemi krenar. Kemi pasur diskutime dhe debate midis nesh në kryesi, madje edhe të ashpra, por duke qenë se kishim të njëjtin qëllim, kemi aritur bashkëpunimin dhe kur kemi marrë vendimin kemi qenë të bashkuar. Kjo është ajo që ka bërë të mundur që shoqata dhe gazeta e saj të jetojë dhe të kenë rezultate shumë të mira.

Kur e themeluan shoqatën, secilit nga ne, po ti kërkohej mendimi do ta kishte shumë të vështirë të thoshte se do të arinim në nivelin ku jemi sot. Shoqata jonë ka një listë të gjatë të arritjeve në të gjitha fushat e jetës së Dukagjinit dhe dukagjinastve kudo që ndodhen. Ne ecëm hap pas hapit dhe gjithnjë në ngjitje deri në vendosjen e shtatoreve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt në qytetin Shkodër. Për këtë patëm edhe, mbështetjen e Kryetares së Bashkisë Shkodër Voltana Ademi si dhe paraardhësi i saj Lorenc Luka. Ishte këmbëngulja e Shoqatës tonë për nxjerrjen në dritë dhe popullarizuar vlerat e Dukagjinit dhe dukagjinastve, e cila pro-

pozoi për të nderuar krahinën e Dukagjinit me dekoratën e lartë “Nderi i Kombit”. Kjo u pranua dhe u mbështet nga Presidenti i Republikës Zoti Bujar Nishani, kështu, Dukagjini u shpall “Nderi i Kombit” më 23 mars 2017. Kjo përbën kulmin e gjithë punës dhe veprimtarisë të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe kryesisë së saj deri sot.

Natyrisht në punën tonë nuk u gjendëm në rrugë të sheshta, në fusha të gjebera, por u ndeshëm edhe në pengesa jo të vogla, të natyrshme dhe të sajuara. Këto të fundit qenë edhe më të vështira, por i kup-



tuam dhe i kaluam, e ne arrimet rezultate gjithnjë në ngjitje.

Ne ishim dhe jemi vullnetar, ne jemi organizatë jofitimprurëse. Por kur kishim nevojë i u drejtuam dukagjinastve tonë në radhë të parë, por edhe miqve dhe dashamirëve të Dukagjinit dhe dukagjinastve. Këta na u gjetën pranë, sepse e kishin të qartë se ndihma e tyre do të shkonte në të mirë të Dukagjinit dhe shoqërisë. E në këtë rast duhet respektuar të gjithë ata që na mbështetën financiarisht, duke hequr nga xhepat e tyre, e mbase ndonjë edhe duke marrë hua tek të afërmit dhe miqtë. Duhet kujtuar me respekt komuniteti dukagjinast por edhe më gjerë i Nju Jorkut të cilët mbuluan 62 % të fondit për ngritjen e shtatoreve të atdhetarit Mehmet Shpendit dhe albanologut Martin Camajt në qytetin Shkodër, komunitetin dukagjinast të Miçiganit, të Brukselit, si dhe atyre individëve të veçantë, brenda dhe jashtë vendit, si Gjergj Leqejza, Ndue Ftoni, Prenda Shpendi, Kolë Çardaku, Martin Bardhoj Martini, Mhill Prroni, Pal Lera, Pal Gjollaj, Sokol Cubi e shumë e shumë të tjerëve, sipas mundësive të tyre, që bënë të mundur realizimin e atyre veprimtarive që ka bërë Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në këto 15 vjet në atë numër dhe në atë cilësi shembullore. Ne, përulemi përpara të gjithë atyre, pa përjashtim, dhe u jemi shumë mirënjohës, me respektin më të madh, por mirënjohës është dhe duhet tu jenë gjithë komuniteti dukagjinast kudo që jeton. Koha do të flasim për punën e shoqatës Atdhetare

“Dukagjini” dhe mbështetësit e saj vullnetmirë.

Gjithë kjo punë e shoqatës dhe gazetës tonë është arritur në grup, në mënyrë të përgjegjshme, por duhet thënë dhe pranuar hapur e pa mëdyshje, se nuk mund të arrihej pa punën organizative, ndihmesën, pa të kudondodhurin, të palodhurin, të përkushtuarin, të guximshmin, të vëmendshmin, të papërkulurin, të vendosurin, në shumë raste edhe përtej mundësive, zotin Ndue Sanaj.

Me këtë punë dhe këto përpjekje bëmë për Dukagjinin, për historinë dhe kulturën e tij, për natyrën, etnografinë, emancipimin e shoqërisë tonë, përmirësimin e kulturës së jetesës, ruajtja e traditave të mira të ardhura nga shekujt, pra në të gjitha fushat e jetës, atë që nuk e bënë shtetarët

shoqatës tonë. Veprimtaria e shoqatës është një histori jo shumë e gjatë në kohë, por, mjaft e gjerë dhe e thellë në punë, veprimtari, e arritje. Do të duheshin shumë fjalë e faqe për të pasqyruar të plotë veprimtarinë e shoqatës tonë.

Personalisht, padyshim gjithmonë, por veçanërisht për këto 15 vjet të punës në Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, si sekretar i saj, jam përpjekur, të jem një dukagjinast i mirë në mendje, në zemër, në punë dhe në marrëdhënie me të gjithë.

Unë ndjem krenar që isha pjesëtar i këtij ekipi i cili bashkërisht arritëm atë që nuk është bërë asnjëherë në Dukagjin dhe për Dukagjinin në drejtim të zgjimit të historisë, evidentimin dhe popullaritetin e saj, që bëmë për këtë krahinë emërmadhe, shkundëm pluhurin e kohës dhe harresës

e kohës, drejtuesit politiko-shoqëror, sistemet të të gjitha ngjyrave e kohëve qofshin, në hulumtimin dhe publikimin e tyre.

Kohët kështu janë, jeta kështu është ndërtaur, dikush largohet e dikush tjetër vjen. Nuk duhet të trishtohemi, të mërzhitemi, apo të shqetësohemi për ata që largohen qofshin edhe të mirë, por duhet të gëzohemi dhe të jemi krenar që i patëm. Kryesorja është që përvoja e fituar, rezultatet e arritura, të mos hidhen por të shërbejnë si mundësi për të bërë më shumë, për të shkruar më tej.

Në bazë të statutit, në vjeshtën e këtij viti do të bëhen zgjedhjet për strukturat drejtuese të shoqatës dhe degëve të saj. Kryesia e shoqatës u drejtohet dhe u bën thirrje anëtarë të saj, por edhe dukagjinastve së pari, që gjatë kësaj periudhe deri në zgjedhje, të afrohen pranë shoqatës, të anëtarësohen sipas statutit, të gjithë ata që dëshirojnë, që kanë ide, që kanë mendime, dhe që marrin përsipër për të bërë punë në të mirë të çuarjes përpara të punës së shoqatës, në të mirë të saj dhe Dukagjinit në tërësi.

Secili mund ti shfaqë mendimet e tij edhe në faqet e gazetës “Dukagjini” e cila do të jenë e hapur në këtë drejtim. Që nga sot fushata konsiderohet e hapur.

Veprimtaria e shoqatës është një histori jo shumë e gjatë në kohë, por, mjaft e gjerë dhe e thellë në punë, veprimtari, e arritje.

Do të duheshin shumë fjalë e faqe për të pasqyruar të plotë veprimtarinë e

dhe punuam për ta vendosur në shërbim të komunitetit tonë.

Ndjehem i plotësuar me rezultatet e arritura nga kjo shoqatë dhe nga kryesia e saj, nga bashkëpunëtorët, shoqëria, respekti reciprok, dhe marrëdhëniet shoqërore.

Ndjej kënaqësi që isha në vendin e duhur, në kohën e duhur, dhe ndihmova në mënyrën e duhur për realizimin e detyrave, për të pasur gjithë përfshirjen, përfaqësimin, vlerësimin, kujtesën, natyrisht duke u përpjekur në mënyrën më të mirë të mundshme, sa herë u diskutua, sa herë u punua dhe sa herë u arritën ato rezultate, të cilat, tashmë, kushdo i ka parë apo mund ti shohë në këto 15 vite. Mund të them pa mëdyshje se mu plotësuan objektivat jo vetëm ato që kisha që në fillim por edhe ato që më dolën rrugës. Unë, besoj, se brezi i ri, dhe ata që vinë do të njohin dhe do ta respektojnë punën e bërë nga të gjithë faktorët dhe aktorët në këtë shoqatë në këto 15 vjet, duke qenë i bindur se kanë përse të flasim dhe të krenohen, midis të cilëve isha edhe unë.

I dashur Dukagjini im!

Unë, do e mbydhë këtu.

Uroj, për zemërsisht, më të mirën për të gjithë ju.

U pafshim për gëzime e të mira!

Luigj SHYTI

Sekretar i Shoqatës Atdhetare

“Dukagjini”

Kryeredaktor i gazetës “Dukagjini”

13.5.2018

Opinione në kuadrin e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”



**MREKULLIA
DUKAGJINASE**

Dedë Zhivani,
Shkodër; 15. maj. 2018

Ditën e diele, me 13 maj 2018, Shoqata Atdhetare “DUKAGJINI” organizoi një manifestim jubilar, solemn dhe artistiko-kulturor e mikpritës, në një mjedis shumë të bukur, siç është ai i Fshatit të Paqes, në Shkodër. Kjo veprimtari ishte i mirë-organizuar deri në detaje, ashtu siç i organizon në vijimësi veprimtaritë kryesia e kësaj shoqate.

Pjesëmarrja ishte jo vetëm e anëtareve të shoqatës, përfaqësues të pushtetit vendor, institucioneve fetare përfaqësues të shoqatave simotra mbare-kombëtare, si brenda territorit të Shqipërisë, po dhe nga shqiptaret e Kosovës, Malit të Zi dhe shqiptaret e Maqedonisë.

Përfaqësuesit e shoqatave simotra e kishin vlerësuar maksimalisht këtë veprimtari, e cila u manifestua, si në fjalët e tyre përshëndetëse, stimujt moral, që dhuruan dhe grupet artistike, të cilat i shoqëronin.

Veprimtaria zgjati dy orë, duke realizuar çdo aspekt të parashikuar më së miri dhe me nivel të larte ceremonial, artistiko-korografik e kulturor dhe me shume dashamirësi e përzemërsi, mes vendasve dhe të ftuarve.

Të pranishme ishin të gjitha mediat lokale, të cilat e regjistruan dhe e pasqyruan në programet e tyre këtë veprimtari.

Pa pretenduar në pasqyrimin e plote, në forme reportazhi të kësaj veprimtarie, me vlera të gjithanshme, si i ftuar që isha dhe nisur nga fakti, se kam qene në vijimësi i pranishëm, pothuajse në të gjitha veprimtaritë e tyre, që në themelimin e kësaj shoqate, fale respektit e dashamirësisë së afruar nga shokët e miqtë tanë që kemi në këtë shoqate, dua të theksoj përmbledhtas, në këto pak rreshta ato aspekte, vlera e mësimi, të cilat janë, jo vetëm arritje e madhe e tyre, po dhe modeli më i mirë e më domethënës, për bashkësitë simotrat e saj, për organizimin e funksionimin e tyre.

Ju, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, sot pesëmbëdhjetë vjeçare ja arritët:

-Të organizoheni e dilni fitimtare duke mposhtur pesimizmin e paragjykimet dhe përballuar vështiruesit e pengesat e mëdha, në rrugëtimin tuaj.

-Të ngriheni mbi mentalitetin paragjykes e obskurantist vendas dhe në plot raste mbi vetveten e mundësit tuaja.

-“Kalin tuaj të betejës”, ju e ushqyet me idealizëm të radhe, ndjenjete fuqishme krahinore e kombëtare, dashuri e krenari superiore, për bashkësinë e vendlindjen tuaj. -Organizimi e synimet tuaja kane qene në vijimësi ambicioze dhe ja dolët të përparoni, nga e thjeshta tek madhështorja, fale përkushtimit, vendosmërisë, ndjenjës së grupit e harmonisë tuaj në veprim, vullnetarizmit, punës vetëmohuese, praktike e intelektuale, vetjake e në grup

dhe realizuat ato objektiva, të cilat mund të dukeshin ëndërrime, të paarrtshme.

-Toleranca dhe fryma gjithëpërfshirëse, pa dallime e paragjykimet ishte shtrati i një lumi të madhe, i cili mblodhi njerëzinë e prurjet historike, tradicionale e kulturore, të zonës suaj në shekujt e ekzistencës e jetesës në këto troje.

-Ju, pavarësisht insinuatave, tentativave e sulmeve, mbajtët jashtë radhëve tuaja frymën përçarëse, dallimet e angazhimet politike.

-Ju si kryesi fale dijeve, kulturës individuale, ja dolët që shoqata dhe veprimtaria e saj të jete i të gjithë dukagjinaseve dhe nuk lejuat, që ajo të behet plasdarme e lojë e të majtëve apo të djathtëve, aspekt ky që ju dha force e mundësi, për të ecur përpara, pa u ndalur.

-Fale organizimit të shendosh e këmbënguljes, ju arritët të shtrini degët e veprimtarin tuaj në të gjithë Shqipërinë e diasporë, ku jetojnë e veprojnë bashkësia e juaj, në Evrope e SH. B. A.

-Shoqatën ju e kthyet në një institucion të vërtetë, me dokumentacion model e arshive të plote, bashkëpunim e korrespondence zyrtare, si partner real e të besueshëm, me simotrat dhe institucionet e pushtetit lokal e qendror.

-Gërmuat me pasion, këmbëngulje e vetëmohim, në historinë, traditën e kulturën dukagjinase, larguat pluhurin e hirin e shekujve të harresës, evidentuat e pasqyruat ato dhe i ngjitet lart në pedestalin e nderit e lavdisë kombëtare.

-Vendosja e lidhjeve, bashkëpunimi e ndërveprimi me simotrat, brenda e jashtë territorit të R. Sh-se, institucionet fetare, mediat e organizatat shoqërore (jo qeveritare) është një arritje e vlerë e shtuar e juaja.

-Në 15-vjet jete e rritje të gjithanshme e të suksesshme, në vlerësimin e gjykimin tim, ju keni edhe disa tregues e lartësi kulmore si:

1-15-vjet gazete “Dukagjini”, e cila po botohet këtë muaj nr. 175 i saj, dhe i vetmi media e shkruar, që botohet në qytetin e Shkodrës, pandërprere në gjithë këtë periudhe kohore.

2-Hulumtimi, botimi e promovimi i dhjetëra e dhjetëra librave, për figurat, historinë, traditën e kulturën e Dukagjinit.

3-Njoha e promovimi i jetës e veprimtarive të shumë figurave dukagjinase në shekuj dhe sidomos ngritja e përrurimi, në qytetin e Shkodrës të monumenteve, të figurave të përmasave kombëtare, të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe të albanologut Martin Camaj.

4-Afrimi e përfshirja në veprimtari-të tuaja, të shumë personaliteteve kombëtare të letërsisë, artit, kulturës, historisë e shkencës.

5-Organizimi shembullor i veprimtarive në terren e institucione, i përkujtimeve e manifestimeve, për 100 vite e arsimit shqip në Dukagjin.

6-Realizimi i dhënies të shume titujve e dekoratave të larta nga institucionet shtetërore e kombëtare, për disa figura dukagjinase e sidomos ajo e dhënies së

urdhrit të larte “NDERI I KOMBIT”, të zonës së Dukagjinit.

7-Njohja, publikimi e shtruarja për zgjidhje para bashkësisë dukagjinase e institucioneve shtetërore të problematikes, që ka zona juaj, për zhvillim e përparim.

8-Organizimi i punës, sensibilizimi i bashkësisë e subjekteve të biznesit, për grumbullimin e fondeve e përballimin e problemeve të mëdha financiare përben, jo vetëm arritje të veçante, por dhe një model pune, i cili duhet studiuar e përgjithësuar.

Ju, kryesia e kësaj shoqate (bërthama elitare intelektuale) e saj, meritoni komplimente të veçanta emër për emër, për punën e lavdërueshme e të mrekullueshme, që keni bere. Ju lumtë!

-Ju me përkushtimin e veprimtarinë tuaj i dhatë drite e shkëlqim zonës suaj. I betë shërbimin e nderimin më të madhe, që i është bere në histori.

-Ju shtruat trasenë e një rruge të gjate, në të cilën brezat pasues, mund të lëvizin ngadhënjyes përpara, me fanarin ndriçues të dukagjinit në balle, të cilin ju ja u përgatitet dhe ja u bëtë gati, për të marre stafetën.

-Ju bëtë vërtet histori dhe me siguri pas do ju ndjeke e do ju jehoje LAVDIA e NDERIMI i madhe nder breza.

Me bindje të plotë mund të themi se, ju jeni modeli më i mirë dhe më autentik i një shoqate .

Ju jeni vërtet MREKULLIA, me emrin Shoqata Atdhetare “DUKAGJINI”!

Me nderim e respekt të veçante,



**URIME DAFINË
E BEKUAR
SHOQATA
DUKAGJINI**

- emcione -

Prelë Milani

Po, po sot i mbushi 15 pranvera! Ndonëse linte si pranvera skeptikeve as nuk u shkante në mendje se ti sot do mblidhje miqtë tuaj në hapësirën mbare shqiptare per festuar ditëlindjen e 15-të. Jo, jo nuk janë shumë, madje fare pak Shëngjergja në raport me punët e mira që ke bërë! Shoqata Dukagjini sikur te priste në hije per festuar një ditëlindje anonime, do ishte e si lopa e vjetër jo pjellore që nuk ka çfarë te tregoi tjetër veç rrathëve te brirëve, pasi qoftë per individin aq me tepër per një shoqatë nuk ka gjëmë më tmerrshme se anonimatin. A nuk është sfidë të lindesh, të ritesh, te lulëzosh si idealiste, humane, e mendjendritur në mes të një xhungle materialiste ku vrapojnë kope grabitqarësh të frikshëm dhe ushtri të pa përmbajtura insektesh të uritur që livadhin gjelbërosh e shëmtojnë dhe bëjnë boke. Të cekesh historinë një interval të tillë, më një rruge shndritshme dhe me një lamë të tillë arritjesh është fat i bekuar që i buzëqeshë vetëm atyre që zgjidhin me pune vepra te mëdha fatin e tyre. Nëse

dihet katërcipërisht se Dukagjini është një krahinë historike shembullore e gjymtyrës më të qenësishme kombëtare: Sot shihet qartësisht si dielli në horizont se “Shoqata Dukagjini “ është një Nimfe (Dafinë) e dashuruar deri në infinit me atin e saj. Tata i moçëm mrekullibërës Dukagjin Shoqatën tonë e shndërroi në Dafinë dhe e bekoji si Apolloni me dhuratën e rinisë së përjetshme si kurorë e merituar në perfeksion. Dafine e bekuar falë dashurisë dhe punës tënde si sistematike si bleta, Dukagjini kurë në historinë e tij qindra vjeçare nuk ka qenë kaq i ndriçuar nga hijet errëta të historive mizore që ju veshën si re zezë qiellit shqiptare .Dafine e bekuar falë dashurisë dhe punës tënde si sistematike si bleta, Dukagjini kurrë nuk ka qenë më mirë-organizuar më i motivuar në fushën promovimit të vlerave të tij Dafine e bekuar falë pasionit, farëzimit dhe vullnetit tënd të çeliktë , Dukagjini kurrë nuk ka qenë më pjellor në fushën e botimeve publicistike, letrare, shkencore. Kurrë nuk ka qenë më përformues se sot në aktivitete artistike, koncerte, seminare shkencore, manifestime. Dafine e bekuar falë dashurisë dhe punës tënde si sistematike si bleta, Dukagjini Nderi Kombit kurrë nuk ka patur ka q shumë miq e dashamirë gjitha flitet shkruhet e këndohet shqip. Dafine e bekuar falë zgjuarsisë dhe mirësisë tënde , Dukagjini “Nderi Kombit” kurrë nuk ka patur prestigj dhe autoritet me larte intelektual e kulturor se sot. Dafine e bekuar falë zgjuarsisë dhe guximit per thënë te vërtetën, edhe vetëm vërtetën as armiqtë më zi të shqiptarizmit as jashtëqitjet më neveritshme shqiptare, nuk guxojnë as nuk do guxojnë më kurrë të lëshojnë më sy proshektorët e ndezur të mallkimeve të tyte fanatike. Dafinë e bekuar urim i zakonshëm dhe klishe e njohur ne raste ditëlindjesh: U bëfsh 100 vjet është shumë pak në raport me uratën time -Te lumtë dora per një faqe historie që shkrove në librin pa njollë të Dukagjinit. Paç fatin e mirë te shkruash edhe faqe te tjera ne ardhmen!

**NJË PASQYRIM, ME
RASTIN E 15 VJETORIT
TË SHOQATËS
ATDHETARE
“DUKAGJINI”**



Agron Isa Gjedia

Pas një ftese të ardhur me 4 maj 2018, nga z. Ndue Sanaj, drejtues i një shoqatë simotër të Shoqatës Mbarëkombëtare “Bytyçi”, Tiranë-Prizren, e pikërisht Kryetar i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” për të marrë pjesë në një manifestim të organizuar me rastin e 15 vjetorit të themelimit të sajë, për mua nuk kishte ndonjë mëdyshje për të mos marr pjesë. Mungesa

e mëdyshjes vinte për të vetmen arsye se kjo shoqatë, e cila kishte 15 vjetorin e formimit të sajë jo vetëm në letër dhe aktet e themelimit, sikurse i kanë përvjetorët një mizëri shoqatash, anonime të pakuptimta apo edhe të manipuluar, por këtë përvjetor kjo shoqatë e kishte pas 15 vitesh veprimtari të pandara e të dëshmuara, shoqërisht të shëndetshme dhe si e tillë duhej nderuar.

Për të ardhur aty nga lindi ngacmimi i refleksionit të mësipërm, theksoi se ditën e manifestimit të organizuar nga Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ashtu sikurse ishte paraparë u mbajt më datën 13 maj 2018, ditën e Diele, në orën 13. 00, te Fshati i Paqes në Shkodër, në një vend që vërtetë i kishte hijeshi ky emërtim, mbajtjen veprimtari kulturore e artistike. Pati shumë të ftuar, individ e anëtar të shoqatës, personalitete të ndryshme dhe të ftuar nga pushteti vendorë, shoqata simotra nga Kosova dhe Shqipëria të cilëve u shërbeu takimi në fjalë për të përfutur nga përvoja e kësaj shoqatë, por edhe për tu njohur më njëri-tjetrin e të shkëmbejnë përvojat, të vendosin dhe forconin lidhjet në mes tyre, por edhe për të përforcuar besimin se çdo punë e mirë, pavarësisht situatave të ndryshme len gjurmët e veta e jep impaktet shoqërisht të dobishme.

Ashtu sikurse ishte planifikuar, programi filloi në orën 12. 00 deri në orën 13. 00 pritja e të ftuarve, në orën 13. 00 deri në orën 14. 30 dreka për miqtë, në orën 15. 00 deri në orën 16. 00 fillimi i veprimtarisë në sallën e koncerteve: - Hapja me këngën "Dukagjini Nderi i Kombit" nga grupi i këngëtareve; - Vijoi me fjalën e Sekretarit të Shoqatës, Luigj Shyti, për jetën 15 vjeçare të shoqatës duke u pasuar fjala e tij me këngë e valle, recitime dhe ndarje të titujve të nderit. Në emër të Shoqatës "Bytyçi" nga organizatorët u ftua në foltores për të përshenjor edhe z. Agron Isa Gjedia, i cili "u përcollti përshëndetjet ma të përzemërta pjesëmarrësve të asaj veprimtarie, i falënderoi organizatorët për ftesën, nuk la pa vu në pah shembullin e mirë e kontributin me vlera qe ka dhënë dhe po jep Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në ruajtjen dhe kultivimin e traditave më të mira të popullit tonë. Me atë rast i bëri të ditur sallës se Shoqatës "Bytyçi", e ka vlerësuar Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", dhe po ashtu edhe Kryetarin e sajë z. Ndue Sanaj. Por ai sqaroi se në këtë rast do të dorëzoj vetëm vlerësimin që është marrë për atë, që vetë shoqata në fjalë e ka zgjedhur dhe e mban të pare të saj, kurse vlerësimin për shoqatën do ta mbajë si "peng", për ta dhënë në një rast tjetër të caktuar. E pikërisht atë do ta japin me 26 Gusht 2018, në manifestimin mbarëkombëtar që do të organizon Shoqatës "Bytyçi", për të 15 vit radhazi të emërtuar si "Festa e Plisit të bardhë", si një nismë për tu shpallur festë mbarëkombëtare. Në atë festë jeni të mirëpritur për të marrë pjesë veç të tjerëve edhe çdonjëri nga ju që jeni prezent. Vlerësimi Shoqatës "Bytyçi", për kryetarin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj u lexua i plotë para të pranishmëve, përmbajtja e të cilit është si më poshtë vijon: Shoqata Mbarëkombëtare "Bytyçi", Tirane-Prizren, me vendimin e saj Nr. 141, datë 01. 05. 2018, Vendosi, për dhënien e çmimit, dukë u mbështetur në

propozimin, që i ka ardhur kësaj shoqatë, nga sektori i vlerësimit të personaliteteve dhe kontribuuesve për funksionimin organizativ të shoqatës tonë, në zbatim të kriterëve të përcaktuara në vendimin normues Nr. 12 datë, 16. 09. 2006, "Për përcaktimin e titujve e çmimeve të nderit", i pasuruar përmes vendimeve të tjera, në kuadër të tetë vjetorit të jetësimit të nismës së kësaj shoqatë që "Festa e Plisit të Bardhë" të shpallët si festë mbarëkombëtare, si dhe mbajtjes së edicionit të 15 të festës së Bytyçi, por edhe shpalljes së vitit 2018 si "Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit", si dhe vitit jubilarë të dhjetëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me votim unanim vendosi: Ta vlerësojnë z. Ndue Sanaj Kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Shkodër Çmimi "Plisi i bardhë emblema hyjnorë e shqiptarisë", i klasit të parë, me motivacion: "Me punë dhe përpjekje të pareshtura në krye të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ka arritur që në këto pesëmbëdhjetë vite të veprimtarive të kësaj shoqatë ta bëjë atë me kapacitete të larta institucionalë, duke e rreshtuar në shoqatat më aktive dhe të përkushtuar në vend për organizimin e shoqërisë civile. Njëkohësisht ka mundësuar që kjo shoqatë të jetë model referimi për mbajtjen gjallë të frymës patriotikë në këtë kohë të trazuar, kultivimin dhe ruajtjen e traditave më të mira shpirtërore, material dhe kulturorë të popullit shqiptarë".

Kur pasi pjesëmarrësit e lanë sallën pas përfundimit të veprimtarive në të, dalën jashtë saj, vijoi faza e dytë të veprimtarisë, ajo e sfilatës më veshje tradicionale të krahinës dhe grupeve artistike qe morën pjesë, të cilat u demonstruan kryesisht nga djem dhe vajza të reja, por edhe të gjeneratave të ndryshme, ku përveçse koncertit në sallë morën pjesë edhe pjesëtarët e Ansambllit Folklorik Autokton "Rugova", të cilët kishin ardhur nga Kosova enkas për këtë ditë. Edhe koktej i shtruar në mbyllje të veprimtarisë ishte edhe një rast tjetër që pjesëmarrësit të takoheshin, njiheshin dhe shkëmbejnë mesazhe me njëri-tjetrin dhe në fund të përjetonin një ndarje të hareshme, më urimin për tu takuar përsëri, duke u ndarë të bashkuar.

Pasi u përshëndetëm me të zotet e shtëpisë, kaluam oborrin dhe rrethimin e vendit ku u mbajt veprimtaria, por edhe lumen Buna.

Me vëllezërit tanë nga Kosova ishin për një kafe bisede, akoma pa e marrë rrugën e kthimit. Ne atë pasdite të qetë dhe plot më diell, pas përfundimit më sukses të asaj veprimtarie, më pare se sa të ndaheshim me njëri-tjetrin, rëndi dhe nderi i vendit dhe jo vetëm e kërkonte, qe më të largëtit e asaj ditë takimi të ftoheshin edhe për nja kafe e bisede rrafshje. Për këtë gjë vendi u gjet më së miri, në hyrje të Shkodrës, në këmbën e malit të kështjellës "Rozafa", në bregun e Bunës ku u ndalem për të kaluar disa çast se bashku me zotërinjtë Ismet Krasniqin-Lala, Prend Buzhalën, Idriz Berisha-Xhixhi, dhe Gjon Gjergjaj-Lyra, të cilët më pas do të kthehen për në Kline.

Në atë ndeje, së bashku ndamë disa çaste të paharrueshme me biseda të ndryshme, humor dhe tregime që vlejten më së miri. Më në fund

edhe nga ky takim u ndamë të bashkuar, me përshtypjen e përbashkët se të tilla takime i shërbejnë të mirës së përbashkët dhe uruam njëri-tjetrin, që sa më parë, së paku të takohemi në veprimtari të tilla.

NË FESTËN E MADHE TË SHOQATËS ATDHETARE "DUKAGJINI"

Rrahman Jasharaj , kryetar,
Sindikata e Bashkuar e Arsimit,
Shkencës dhe Kulturës e Kosovës

Shpalojse e arritjeve të mëdha në ditëlindjen e pesëmbëdhjetë!

Janë të bukura e plot emocione festat mes vëllezërve e motrave të një gjaku. Plot madhështi ishte edhe ngjarja e mad-



he kulturore në Fshatin e Paqes te Shkodra e kulturës dhe artit shqiptar. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" kishte bashkuar , si gjithmonë, vëllezër e motra nga gjithë trojet shqiptare për të kremtuar bashkë e për t'ju gëzuar arritjeve të shumta në 15 vjetorin e themelimit të kësaj Shoqate. Kryetari Ndue Sanaj me atë buzëqeshjen e lehtë e vëllazërore po priste pjesëmarrës në këtë festë e që po vinin nga të gjitha trojet shqiptare. Pranë tij, si gjithmonë, qendrorin e angazhoheshin që çdo gjë të shkojë mbarë edhe anëtarët e kryesisë së kësaj Shoqate me emër e imazh shembullor.

Mes mysafirëve të shumtë ishte edhe delegacioni i Shoqatës së vëllazërisë Kosovë Malësi e Madhe "Martin Dreshaj". Kjo Shoqatë me vite ka bashkëpunuar si vëllai me vëllanë me dukagjinasi. Kanë organizuar edhe shumë aktivitete andej e këndës Dukagjinit në shërbim të unifikimit kulturor të vëllezërve të një gjaku. Kishin ardhur në këtë festë edhe këngëtarë, valltar e poetë nga trojet shqiptare e mes tyre ishte edhe Ansambli Folklorik Autokton "Rugova", që ia shtoi bukurinë kësaj feste të madhe.

Në fillimet e festës të gjithë u gjenden në një ambient të mrekullueshëm dhe duke ngritur dollinë e duke përgëzuar Shoqatën Atdhetare Dukagjini për arritjet e shumta, shkëmbyen ide për bashkëpunimin kulturor edhe në të ardhmen.

Në programin solemn kryetari Sanaj bashkë me veprimtarë të tjerë të Shoqa-

tës ndanë mirënjohje njerëzve të vullnetit dhe zemrës së mirë në shenjë respekti për punën e tyre dhe kontributin dhënë Shoqatës. Shumë folës nga trojet etnike me respekt të lartë kanë shpalosur punën dhe angazhimet e mëdha të këtyre njerëzve të vullnetit të fortë. U tha me arsye se Dukagjini ka arsye të krenohet me bijtë dhe bijat e tij sepse ata përmes kësaj Shoqate i kanë zbardhur fytyrën trojeve të tyre stërgjyshore kudo kanë shkuar.

Mes atyre që kanë përshëndetur këtë festë të madhe ishte edhe kryetari i Ansambllit Autokton "Rugova" Vesel Nikçi. Ai kujtoi shumë nga aktivitetet e përbashkëta të Ansambllit të Shoqatës Dukagjini dhe shprehu gatishmërinë që edhe nëpër vite e dekada ta vazhdojnë këtë bashkëpunim në shërbim të kulturës sonë.

Koordinatori për bashkëpunim me trojet etnike i Shoqatës së vëllazërisë Kosovë- Malësi e Madhe "Martin Dre-

shaj", Rrahman Jasharaj duke përshëndetur këtë ngjarje të madhe ka kujtuar se tani e 10 vite kanë bashkëpunuar në dhjetëra ngjarje kulturore me vëllezërit e Shoqatës "Dukagjini".

"Bashkërisht e duke marrë shembull të mirë të punës së përkushtuar nga vëllai ynë Ndue Sanaj vërtetë kemi hapur shtigje të reja duke i sjellë në një këngë e në një valle artsitet nga trojet shqiptare. Bashkëpunimi vëllazëror mes dy shoqatave tona është shembulli dhe dëshmia më e mirë se kur shqiptarët janë bashkë janë më të mirët dhe janë në shërbim të kulturës dhe atdheut në përgjithësi", ka thënë Jasharaj për të ftuar pastaj në skenë kryetarin e Shoqatës "Martin Dreshaj", Ukshin Jasharin, sekretarin Frashër Rraci, veprimtarin Gazmend Leka dhe kryetarin e Teatrit "Aleksandër Mosiu", Fadil Grabovcin për t'i ndarë mirënjohje Shoqatës "Dukagjini" në shenjë respekti për bashkëpunimin vëllazëror dhe për arritjet kulmore në kulturë, art e letërsi.

Në këtë festë të madhe ansamblet dhe këngëtarët kanë shpalosur vlera të larta kulturore kombëtare .

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" do të ketë gjithmonë vetëm ditëlindje nëpër vite, dekada e shekuj.

Urime vëllezër kjo festë e madhe .

DERI KUR DO TË KETË MJEGULL NË HISTORINË E DUKAGJINIT?

Tjetërsimi, manipulimi apo hamendja në një ngjarje historike, nënkupton mungesë formacioni, padituri ose tjetërsim të qëllimshëm i m' veshur me lokalizëm që jo rralle po përsëritet në shumë ngjarje historike për Pultin, për të cilat ka pasur shumë refleksione në disa botime librash, që të çojnë në atë që quhet...kriminalizim historie. Kush shkruan në histori dhe del jashtë pistës reale, ai mbetet një pseudo-historian, që noton në miopinë e shkencës së historisë, që herët apo vonë mbetet mbetje sikur papastërtitë që nxjerr deti në breg, sepse historia është e shkruar.

Dukagjini ka intelektual dhe personalitete të nderuara dhe të respektuara në të gjitha fushat, dhe jo të pakta janë refleksionet e tyre në këtë drejtim. Ne jemi inkurajues, por edhe kritik duke kërkuar mirëkuptim në mbrojtje të së vërtetës, në të kundërt mbetemi fajtor në deformimin e historisë duke e dëmtuar rende atë që do të ketë kosto për brezat e mëvonshëm.

Të pavërtetat do të citohen pa frike dhe të korrigjohen, në të kundërt janë ndotje e realitetit në ngjarjet historike dhe çfarë është më e keqja, këto gënjeshtër publikohen në shume referenca e kumtesa duke u referuar këtyre shkrimeve. Një

rast i freskët dhe shumë i papërgjegjshëm ndodhe me studiuesin Mark Palnikaj nga Nikaj-Merturi në librin "PULTI", faqe 247 për luftën e vitit 1915-es në Gjuraj-Plan, i cili i referohet librit të Prele Milanit e Lazer Kodres "DUKAGJINI YNE", duke deformuar tërësisht atë Qëndresë të banoreve të Planit, një nder ngjarjet më të lavdishme të Dukagjinit dhe të shekullit XX, ku shkruan: "...Në fshatin Plan të Pultit të Dukagjinit, forcat serbo-malazeze, me datën 15 korrik 1915' masakruan brenda në shtëpitë e tyre pa asnjë faj 79 persona, kryesisht gra, pleq e fëmijë në djep...", në faqe 249. Fëmijët i theren me bajoneta në sy të nënave të tyre duke ua prerë kokat e duart për ti marre si trofe për tu mburrur para eproreve të tyre e tjerë e tjerë. Kjo është fjale për fjalë gënjeshtër, sepse asnjë fëmijë nuk është vrare dhe asnjë grua shtatzëne dhe asnjë plak, vetëm një që është djeg në kull, vetëm dy gra që kanë luftuar me burrat e tyre dhe asnjë koke njeriu as dore nuk është prere, por të gjithë këta që kanë renë dhe janë shpallur dëshmor të Atdheut, me një moshe mesatare, në bazë të certifikatave të gjetura në kishë, kane qene në moshën 30 deri në 32 vjeç. Gjeja e pare që duhet të bëni zoti

Mark Palnikaj, të publikoni gënjeshtër të qëllimshme të Prel Milanit dhe të Lazer Kodres lidhur me këtë ngjarje në librin "Dukagjini Ynë-1" dhe "PULTI"; duhet që të përgënjeshtroi shkrimet tuaja dhe ti kërkoni të falur bashkësisë Plan-Gjuraj.

Shumë befasuese është shkrimi i zotit Prele Milani në librin e fundit, monografia "Profesor Kole Prele, deputeti historik i Dukagjini", në faqen 93, ku shkruhet: "Sipas udhëzimeve të tij vepërimtaret më të mirë të Dukagjinit ngritën kudo Këshilltarë të riye N. Ç. Lufta përfundoj me sukses në Shalë, Shesh e Pult nuk pati asnjë pikë gjaku të derdhur shqiptari me shqiptar, asnjë njeri të vrare ase të plagosur, asnjë shtëpi të djegur, asnjë familje të internuar nga fitimtarët e riye. Ky ekuilibër do të prishej pas arrestimit të Kole Preles, deputetit të pare historik të Dukagjinit".

Ne, në vjen keq për një intelektual si Prel Milani të kaloj në një absurditet të tillë. Ne, i rikujtojmë Preles se jo pikë gjaku, por lum gjaku ka pasur në prag të çlirimit. Me 27 Nëntor 1944, në Qafë Thanë, partizanët e Brigadës e 6 Sulmuese kane vrarë 10 djem nënash pa asnjë faj, vetëm për hakmarrjen e Çelo Sinanit

dhe pasi është plaçkite me çka kane pasur, kane djege natën e Shënkollit krejt Khanin mbare me lagjen Preçaj, Nenbreg, Athije dhe Alavana. Një prej të vrarëve, z. Prele ishte edhe bashkeshoshiani i juaj, Mehil Vocri 17 vjeçar, djalë i vetëm. Pra, bëhet fjalë për lum gjaku, e jo të plagosur, por të vrarë.

Në ditët e para të Dhjetorit janë vrare vetëm në Pult 19 burra për një armë.

Zoti Prele morëm këto dy raste duke anashkaluar shumë të pavërteta lidhur me krahinën e Pultit si psh. me figuren e Zef Males, Politologun më të madh shqiptar, themeluesin e Partisë së pare Komuniste-Socialdemokrate, Deputetin e pare Dukagjinas me Kole Prelen dhe ju e përshkruani aq të zvogëluar duke e quajtur studente i filozofisë e tjerë. Pra, do ishte në nderin tuaj për këto falsifikime të reagoni dhe të përgënjeshtroi ato fraza dhe të kërkoni ndjese familjareve te të rënëve, në emër të së vërtetës dhe gjakut të derdhur dhe dhimbjes së madhe me shumë fise të fikura.

*Shoqata Patriotike
Kulturore 'SPANI', Pult*

Familja: vendi i dashurisë, edukimit dhe mirëqënies

Me dt 15 Maj 2018, tek Fshati i Paqes, familja e madhe e Projektit Shpresa, e Institutit të Motrave të Nënë Terezës dhe Shoqatës "Maddonina del Grappa" patën kënaqësinë e veçantë të mblidhen së bashku me rastin e Ditës Botërore të Familjes. Të gjithë të rinjtë ishin të shoqëruar nga kujdestarët socialë dhe përfaqësues të shoqatave respective. Në këtë ditë të gjitha kombet bëjnë thirrje për një bashkim, por ku mund të ketë bashkim nëse nuk nisim që në familje. Pikërisht në respekt të kësaj dite, u organizua aktiviteti i titulluar "Një shtëpitje me familjen" deri tek Fshati i Paqes. Kjo sepse së pari, besojmë se familja është institucioni i parë njerëzor dhe mikrokozmos i komunitetit njerëzor global. Së dyti, familja është universale. Pavarësisht nga raca, kombësia, etnia, apo besimi fetar, secili nga ne bën pjesë në një familje dhe duhet të bëjë pjesë në një familje. Mbi të gjitha familja është shkolla e dashurisë dhe paqes. Themeluesit e Federatës së Paqes Universale, gjatë gjithë jetës së tyre kanë theksuar se familja është gurë themeli për paqen dhe për këtë qëllim të treja Shoqatat janë përkushtuar të jenë një ndër zërat kryesorë në mbrojtje të familjes për personat me aftësi ndryshe të cilët kanë probleme psikosociale si nuk kanë interesime familjare, janë të braktisur apo të neglizhuar. Në hapjen e këtij aktiviteti, fjala iu dha Z. Luigj Mila, Presidentit të Shoqatës "Projektit Shpresa" dhe Z. Fabrizio Nocchi të cilët e vunë theksin sidomos tek rëndësia e dashurisë që ofrohet në shtëpi familje për të rinjtë me aftësi ndryshe që nuk kanë interesime familje. Për kënaqësinë e gjithë të rinjve, ishin të pranishëm këngëtare aktivistë të Kishës Katolike, këngëtarët e dashur si Jozefina Guri, Jolanda Laloshi dhe Roland Gjoka të cilët dhuruan momente të mrekullueshme



dhe të paharruara për gjithë të rinjtë dhe të pranishmit. Po ashtu i ftuar ishte edhe Dom. Vlash Palaj, Famullitari i Katedrales "Shën Shtjefni", i cili përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe krahas rëndësisë së ditës botërore të familjes, ndër të tjera vuri në dukje edhe eskperiencën e mëparshme në Kampin Veror të Projektit Shpresa. Për mbarëvajtjen e këtij aktivite-

ti u kujdesën shumë persona dashamirës dhe ndër ta theksojmë ndihmësen e konsiderueshme të Pader Gjoni, përgjegjësi i Fshatit të Paqes. Në mbyllje, themi që paqja e qëndrueshme sigurohet jo vetëm nga ligjet apo fuqia e qeverive për zbatimin e tyre, por nga një ndërgjegjësim në rritje i solidaritetit universal se ne jemi një familje njerëzore, që ndajmë një trashëgi-



mi të përbashkët shpirtërore dhe morale nëpërmjet të cilës marrim ndjenjën më të fuqishme njerëzore, dashurinë, edukimin dhe mirëqënien e përgjithshme. Ne jemi një familje nën një Zot. Ndaj një bashkim i tillë u realizua në mbështetje të vlerave të shtëpisë familje shqiptare për personat me aftësi ndryshe dhe vlerave universale të paqes.

Faleminderit o Zot.

Përgatiti dhe organizoi: *Suela Ndoja & Adriana Marku*

45 VJETORI I REVOLTËS SË BURGUT TË SPAÇIT

Me 21 Maj 2018, shoqata "Muzeumi i Burgut të Spaçit" në bashkëpunim me: Komisionin Drejtësi dhe Paqe; Institutin e Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë; Institutin e Studimit të Krimeve të Komunizmit; Bashkinë e Rrëshenit; Shoqatën Antikomuniste të Ish të Përndjekurve Politikë; Institutin për Demokraci Media dhe Kulturë, organizoi në mjediset e ish burgut të Spaçit një ceremoni përkujtimore, me rastin e 45 Vjetorit të revoltës, e cila shpërtheu mes të dënuarve, me 21 maj 1973.

Kjo revoltë ka rëndësi të veçantë për historinë e demokracisë në Shqipëri jo vetëm për kohën dhe vendin ku u zhvillua, por për faktin se gjatë saj u artikuluan aspiratat për demokraci perëndimore dhe u denoncua komunizmi.

Një moment tjetër shumë i rëndësishëm i revoltës, është ngritja e flamurit kombëtar, pa yllin komunist, në terracën e një rreze prej godinave.

Revolta zgjati tre ditë para se të shtypej me ndërhyrjen e trupave speciale të ushtrisë.

Katër nga protagonistët dhe organizatorët e revoltës u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan.

Emrat e katër martirëve të Revoltës së Spaçit janë: Dervish Bejko, Skëndër Daja, Pal Zefi dhe Hajro Pashaj.

Në ceremoninë e përkujtimit të 45



vjetorit marrin pjesë autoritete të larta shtetërore si Presidenti i Republikës, Shkelqesia e tij, Ilir Meta; përfaqësues të selive diplomatike; drejtues të organizatave të ish të përndjekurve politikë, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", si dhe një numër i madh personash që kanë vuajtur persekutimin komunist në një mënyrë apo një tjetër.

Ky organizim vjen në kuadrin e projektit "Ballafaqimi me të Kaluarën Komuniste", i cili mbështetet nga organizatat gjermane "Renovabis" dhe "Maximilian Kolbe Stiftung" dhe synon informimin dhe edukimin e brezave të rinj me të vërtetat e së kaluarës në mënyrë që ajo të mos përsëritet.

Vladimir Banushi

Promovimi i librit "Zoja e Shkodrës, drita e Shqypnis"

Pasditën e së enjtes së datës 3 Maj 2018, në muajin që në mbare bota katolike ia kushton "Zojës së Këshillit të mirë", u promovua libri "Zoja e Shkodrës, drita e Shqypnis". Botimi përmbledh aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare që u mbajt në 22 prill 2017 në Shkodër me rastin e 550-vjetorit të zhvendosjes së figurës së "Zojës së Këshillit të Mirë", nga kisha e Zojës së Shkodrës, në Gjenacano, Itali. Libri u promovua në ambientet e sallës "Kardinal Mikel Koliqi", ku të pranishëm si nderim ndaj këtij promovimi ishin nga strukturat qeverisëse kryetarrja e bashkisë së Shkodër, znj. Voltana Ademi, deputet i qarkut Shkodër z. Lorenc Luka, Gjithashtu z. Gjergj Leqejza, Konsull i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër. Të pranishëm ishin edhe nga Shoqata Atdhetare Dukagjini, Kryetari Ndue Sanaj dhe anëtarët Lazer Kodra, Kole Çardaku, Prele Milani, Luigj Mila, Roza Pjetri dhe Klodjana Serraj.

Ndërsa të pranishëm për të mbajtur fjalën e tyre përshëndetëse, për të folur mbi rëndësinë e librit dhe të kuptuarit sa më sakte të Zojës së Shkodrës ishin Shkelqesia e tij imzot Angelo Masafra, prof. Arben Prendi, pedagog në universitetin e Shkodrës, departamentin e Letërsisë, Magjistër Pjerin Mirdita si përfaqësues i Muzeut "Në Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës". Libri vjen si

një Mbështetje e Madhe edhe nga Biblioteka "Marlin Barleti", që përfaqësues i saj ishte i pranishëm drejtori i bibliotekës Gjovalin Çuni, i cili luajti dhe detyrën e moderatorit të këtij promovimi.

Më pas në fund të promovimit nën udhëheqjen e Shkelqesisë së tij imzot, An-



gelo Masafra u bë inaugurimi i pjesës së dytë e Muzeut Dioqezian me objekte që vinin si dëshmi të kohës së ruajtës së besimit dhe vlerave të besimit katolik, ishte vete monsinjor Masafra që ua prezantoi të pranishmëve objektet ku mes të cilave theksoi Shën Prosperin, i cili fillimisht ishte pjesë e katedrales e më pas u bë pjesë e Muzeut Ateist.

Zoja e Shkodrës apo Zoja e Kshillit të Mirë paraqet një imazh të njohur të Shën Marisë me Krishtin fëmijë. Kompozimi paraqet një figurë të saj nga mesi e lart, ku Maria mban fëmijën me kraun e saj

të majtë në një atmosferë të ngrohtë afërimiti. Portretet janë trajtuar me delikatësi dhe profesionalizëm. Portreti i Virgjëreshës mban vështrimin poshtë dhe prek pak Krishtin me sytë blu, që njëherë dorë e mbështet në gjoksin e Marisë, ndërsa dora tjetër përfundon butësisht në qafën e saj. Të dyja figurat paraqiten në një hapësirë të thjeshtë, me një sfond

të errët, ku dallojnë dy aureola të ndryshme mbi kokat e tyre si dhe një ylber shumëngjyrësh që përshkon sfondin. Piktura është ekzekutuar me ngjyra vaji mbi një shtrat përgatitor shumë të hollë, në një kanavacë të thurur dendur.

Kjo ikonë gjendej në kishën kushtuar Sh. Marisë në Shkodër. Historia e njohur e këtij imazhi fillon në 25 Prill 1467, kur vepra (një fragment afresku i prerë dhe i hequr) u zhvendos nga një mur i kishës së vjetër agostiniane Shën Maria në Shkodër dhe u vendos në Santuarin e Maddona del Buon Consiglio në Genazzano, një kishë ndërtuar që në shekullin e dhjetë pranë Romës. Sipas një legjende, në vitin 1467, kur trupat osmane e mbanin Shkodrën në rrethim e kërcënonin të ç' shenjtëronin kishën, piktura u shkëput për mrekulli nga muri dhe e mbajtur nga engjëjt u largua nga ndërtesa dhe mori fluturimin drejt perëndimit mbi detin Adriatik për në Itali. Në këtë largim e ndoqën dy shtegtarë shqiptarë, Gjergji dhe De Sclavisi. Këshilli i katërt i peshkopëve shqiptarë, i mbajtur në vitin 1895, e shpalli Zojën e Shkodrës "Pajtores të Shqipërisë". Shkodranët e shprehin në këngë mjerimin që pushtoi qytetin pas shtegtitimit të Figurës së Zojës dhe pushtimit osman:

"Qysh at ditë që na u largove,
Te tana të zezat na kan ra".

Dhe kjo si për të rritur besimin ndaj Zojës së Shkodrës muajit, i cilit i kushtohet dhe vlerave të patjetërsueshme që mbart sot besimtarët më shumë se kurrë i lutën asaj.

Klodjana Serraj

KIRI NË VITE

Pak histori

Popullimi i Dukagjinit fillon fund të shekullit XV dhe në fillim të shekullit XVI, sipas periudhave. Në fillim u vendosen në krahinën e Shalës, Shosh e Pult. Në fshatin Kirë erdhi një familje, familja e Nol Bjezhanit nga Peja. Rreth 50 vite më vonë, rreth dy breza më vonë, erdhi edhe familja tjetër nga Kuçi i Malit të Zi.

Në fillim ndërjuan shtëpi me mure guri të thatë. Më vonë, në fillim të shekullit XVII filluan të ndërtonin shtëpitë me mure e me lloç gëlqere dhe me çatia mbulohej me rrase guri. Në fillim u ndërjuan një katesh dhe më vonë dy katesh. Në katin e pare mbanin bagëtitë dhe në katin e dyte banonin vete.

Për të jetuar mbanin bagëti të llojeve të ndryshme, por kryesisht dele e dhi, prej të cilave për veç qumështin e mishin, ju merrnin edhe leshin e tyre për të përgatitur veshmbathje dhe fjetje.

Për sigurimin e bukës, në fillim mbillej thekra, më vonë misëri, të cilin për here të pare e solli Ipeskvi i Pultit, në Xhan. Në fillim të shekullit XVIII, u shpërnda në disa familje, dhe më vonë kjo fare e misrit mori disa emra, sipas atyre familjeve që e përdoren të paret, si fara e Lul Gjonit, Boçit, Doçit e të tjera. Ajo ishte fare me cikël të mesëm. Më vonë erdhi fara "Amerika bardhe", me cikël më të gjatë. Me kalimin e viteve, në Kirë sollën edhe farën e Thethit, me cikël të vogël, e cila mbillej në parcela pa vaditje. Këto farëra misri u përdoren deri në vitin 1970. Me organizimin e kooperativave bujqësore u zëvendësuan me llojet e hibrideve me prodhimtari më të lartë e qëndrueshmëri ndaj faktorëve atmosferik.

Me shtimin e popullsisë, u rrit edhe sipërfaqja e tokës are, duke ndërtuar parcela nga 100 m² deri në një dynym, ose më shumë.

Për zhvillimin e bujqësisë e blegtorisë në fshatin Kirë, po konkretizoj me rezultatin e prodhimeve të vitit 1979, ku kam punuar si specialist i sektorit, agronom. Në këtë vit ishin këto rezultate:

*Misër u morën 1930 kv;

*Patate u morën 1 155 kv;

*Qepujka u morën 408 kv;

*Fasule u morën 86 kv;

*Fruta, gështenja, arra, kumbulla e të tjera, u morën 965 kv;

*Në blegtori, gjedhe gjithsej 350 krerë; bagëti të imta 1470 krerë dhe prej

te dyjave bashke u morën mbi 2 000 kv qumësht.

Fshati i Kirit, në fund të vitit 1990 kishte 133 shtëpi, me 1 130 banorë dhe 188 ekonomi familjare.

Gjendja e vitit 2018

Me ndryshimin e sistemit, fshati Kirë po thuhet u braktis plotësisht. Sot janë 35 familje. Nga 67 ha toke are, toke buke, që mbilleshin, tani mbjellën rreth 11 ha. Toka e mbetur djerr po shkon drejt degradimit. Janë shembur muret mbrojtëse të parcelave, nuk mirëmbahen kanalet kul-luese, si rezultat dheun e parcelave po e merre lumi, po i marrin përrenj. Shtëpitë e braktisura po shemben e po kthehen në gërmadha; pemët frutore po thahen dhe

por edhe kjo trase po, shkon drejt shkaktërimit, mos funksionimit total.

Shkollat e qendrat shëndetësore janë kthyer në gërmadha.

Deri kur do të vijohet kështu?!

Perspektiva

Dukagjini i TRI mrekullive, që nuk i ka asnjë zonë në Shqipëri, Malin, Ujin e Bimësinë.

Dukagjini, që përshkohet nga dy lumenj, lumi i Shalës dhe lumi Kirit.

Dukagjini, që përshkohet me rruge makina çdo fshat, sidomos fshati Kirë, që ka rruge pothuajse për çdo lagje të tij.

Dukagjini, shembull i trashëgimisë kulturore në shekuj, bazën e këtyre fak-teve perspektiva është e pa shmangshme.

shumë pas në kohë. Mendoj që, shumë më produktive do të ishte krijimi i mikro-fermave bujqësore dhe blegtorale nga disa familje së bashku, siç po aplikohet në Jug të Shqipërisë. Në tokat bujqësore që tashme të degraduara, të mbjellën peme frutore në blloqe, si me gështenja, që është pasuria më e madhe në Kirë dhe në tere Dukagjinin.

Frutikultura spontane, si karakteristike në Dukagjin të shtohet e të mirëmbahet sipas llojeve, arre, molle, dardhe, lajthi e të tjera. Po kështu dhe për mirëmbajtjen e shtëpive, nga banoret që e kane braktise, jetojnë sot brenda apo jashtë vendit të investojnë për shtëpinë ku linden e u rriten.

Themeli i hedhur për turizmin malor në Theth, të marri zhvillim në të gjitha



po kthehet vendi në shkurre e ferra. Numri i gështenjave, që më pare mbilleshin në blloqe, sot jo vetëm nuk mbjellin të reja, por po priten çdo vit. Kjo pasuri e madhe frutore, që më pare është përdorur edhe në vend të bukës si ushqim. Hardhitë në fund të parcelave janë zhdukur plotësisht. Kullotat i kane mbuluar ferrat e shkurret.

Duke u shkatërruar kështu vendi, me të drejte lind pyetja:

Pse, po prishen çfarë ndërjuan brezat më pare? Dukagjini, në këtë mes dhe fshati Kirë, po thuhet, na ishte dikur!?

Kur prindërit tanë e bënëin rrugën e Dukagjinit për në Shkodër në këmbe për tegeti, sot ka rruge të hapur për çdo fshat,

Mendimi im, si specialist në fushën e bujqësisë, është të mos e braktisim këtë pasuri të ndërtuar në shekuj me shumë kujdes e sakrifica. Nuk e mendoj, që të organizohen kooperativa bujqësore, por të punohet me kooperim, të bashkohen sipas bashkësie, sipas marrëdhënieve shoqërore në mbrojtje të pasurisë së tyre, për të nxjerre të ardhurat përkatëse, nga bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria, sipas mundësive e kushteve zhvillimit të secilit fermerë.

Nuk duhet që një familje të mbjellin të gjitha kulturat bujqësore, me përjashtim të perimeve. Gjithashtu nuk jam dakord, që një familje të mbarështroje të gjitha llojet e bagëtimeve, sepse kështu shkojmë

fshatrat e Dukagjinit, sidomos në fshatin Kirë, pasi ka disa përparësi: rruga e makinës përshkon të gjitha lagjet; ka mbi 125 burime uji; me klime të përshtatshme si bjeshke dhe verri; lumi i Kirit përshkon gjithë gjatësinë e fshatit.

Për të realizuar të gjitha këto që theksuam, duhet patjetër, si porta hyrëse e zhvillimit të kësaj zone, duhet së pari të ri-ndërtohet rruga automobilistike, e cila lidh aksin Shkodër – Kir – Shosh – Shale dhe të garantohet furnizimi i vijueshëm me energji elektrike, duke i bere apel Qeverise, që të marri sa më pare nismën e ri-ndërtimit të kësaj rruge jetike për Dukagjini dhe për rritjen e mirëqenies së dukagjinasve. **Përgatiti: Prelë Kroj**

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi ***

LULËKUQES

Jehona e betejave
Për ty, Atdhe
Kur vjen pranvera
Lajme sjell për ne.

Ngjyra kuq e zi
Re që gjëmon
Dëshmorët për liri
Ti na i kujton.

Lulëkuqe e majit
Bukuri e rrallë

Ajo pret djalin
Me dashuri e mallë.

Në mes të gjelbërimit
Të ulur bisedojnë
Me ndjenjat e gëzimit
Lulëkuqet i rrethojnë.

PROMETE KE QËNDRUE

- Manush Alimanit, Hero i Popullit -

Digjet toka kudo zjarr
Ndrin yjet lartë në qiell

Ah, Manushin e kanë marrë!
Zemra e tij ndrit si diell.

Ditë e natë aty në qeli
Mes gjermanësh t'egërsuem
Po qëndron ky djal i ri
Me gjithë trupin të coptuem.

Trego shokët një nga një
Edhe bazat ku qëndrojnë
Qenka hekur, jo njeri
Prap torturat i fillojnë.

Të goditen me zemërim

Gjaku yt shkoi rrëke
Deri n'fund qëndrove trim
Edhe vdiqe për Atdhe.

Një përbindsh me bajonetë
Zemrën tande e ka shpue
Dhe shpirt, aty ke mbetë
Promete ke qëndrue.

O hero legjendar
Bir i Shkodrës heroinë
Ti ke mbetë gjithnjë pishtar
Për të gjithë Shqipërinë.

Luigi Temali

Mjeku dhe kujdesi ndaj të sëmurit është primar



Dr. Ndue Nikaj

Profesioni i mjekut është i shenjtë. Sipas etikës mjekësore, që nga lashtësia, theksohet në të gjitha enciklopeditë se detyra e mjekut është të beje vetëm mire, pa shkaktuar dëmim sipas shprehjes “Primum Non-nocere” (Në radhe të pare mos dëmto. I sëmurit ka besim tek mjeku deri në momentin e fundit të jetës, prandaj latinët theksonin “Dum Spiro Spero” (sa të kem fryme, kam shprese).

Duhet të jeni të kënaqur dhe me fat kur dilni nga ambulatori i mjekut pa ju përshkruar asnjë ilaç në recete për ankesat që keni paraqitur, por ju jep vetëm këshilla për të ndryshuar mënyrën e jetesës dhe për të mbajtur diete etj. Si p.sh të lini duhanin, shtoni veprimtarinë fizik etj. Kjo tregon se mjeku juaj ka qene i vëmendshëm dhe ju ka dhënë këshilla të vlefshme për parandalimin e sëmundjes, duke mos ju dhënë ilaçe të padobishme, gjë e cila tregon se ju akoma nuk jeni vërtetë i sëmur. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodh gjithmonë, madje është krejt e radhe që të mos merrni barna gjate një vizite.

Ilaçe për të shëndetshmit?!

Sot, në fakt shume shpesh bëhen ekzaminime klinike dhe kur nuk janë të domosdoshme para se të shfaqen shenjat e një sëmundje, dhe kjo jo vetëm gjate kontrolleve periodike siç është “check-up-I,” por përshkruhen ilaçe për ankesat më të vogla pa u bere asnjë ekzaminim laboratorik, (sa për të qene brenda) dhe kjo jo radhe u krijon pacienteve shqetësime të panevojshme. Kjo ndodh dhe për faktin se farmacistet ushtrojnë presion mbi mjeket nga që studimet shkencore mbi ilaçet e reja dhe mbi sëmundjet janë shpesh me protokolle te kontrolluara nga interesa komerciale te tregut farmaceutik ose ngaqë mendohet se nga gjithë këto kura dhe analiza jemi të gjithë të “mbrojtur”. Mjekësia, që para se gjithave duhet të jete parandaluese në qëllimin e informimit të pacientit për të përmbushur dhe zbatuar zakone dhe norma të drejta për ushqyerje dhe sjellje për të shmangur sëmundjen, po behet gjithnjë veçse “medikalizim” i shëndetit. Pra, dominon mjekimi, kërkohen trajtime me ilaçe të reja sa më të avancuara dhe për rrjedhoje dhe me kosto te larte, kjo qofte për taksimin publik dhe për siguracionet e shërbimin shëndetësor kombëtar, ku dihet se në të gjithë kontribuojmë me taksa thekson (Barabera Merco, në shkurt 2015).

Disa gjera me të padobishme dhe të rrezikshme që bëhen nga mjeket janë:
Antainflamatorët jo-steroid (AINS)

kundër dhimbjeve: më të përhapurit sipas recetave janë analgjeziket dhe anti-inflamatorët jo kortizonik. Dihet se marrja e shpeshte e tyre si Ibuprofen me sinonimet e veta, momentol, rapidol etj ose dhe voltareni, diclofenac ose naproxeni mund të shkaktojnë efekte të padëshirueshme dhe serioze duke rrezikuar zemrën, duke përkeqësuar tensionin arterial, duke acaruar stomakun deri në hemorragji të rende, me ndikim në diabet, me ndikim mbi veshka deri në insufizence renale tek diabetiket. Në Kohen kur për dhimbjen e kokës apo shpinës preferohet për një kohe të shkurtër acetaminofeni (paracetamoli)

qoftë dhe i serive më të lundit që të ketë rezultat dhe të dominojnë infeksionin si dhe kështu i sëmurit përfundon me vdekje (infausta). Sipas të dhënave franceze arrin në 25000 raste në Evrope. Pra, marrja e antibiotikeve kur nuk janë të nevojshme si në infeksionet virale që përbejnë 85 % të rasteve në kohën që nuk ka asnjë efekt ndaj këtyre infeksioneve sepse antibiotiket janë ati-bakterial dhe jo anti-viral nga qe viruset penetrojnë brenda qelizës. Po kjo ka një rrezikshmëri të madhe sepse krijon bakterio-rezistence, pra, në të ardhmen këto antibiotike nuk do të veprojnë më. Dhe nga ana tjetër

tur dhe për seks. Nëse nuk ju zen gjumi për 20 min nga shtrirja për të fjetur duhet të merreni me një lexim të një libri të këndshëm ose të shikoni ndonjë film gazmor ose mund të merrni në darkeushqime që përmbajnë melatonin si pjeshka, perime, arra dhe lajthi ose qumësht, djathë, që përmban triptofan, i cili po ashtu favorizon po ashtu gjumin dhe së fundmi mund të merrni pilula të melatonines në dark 10-15 miuta para gjumit.

Bëhen radiografi të gjoksit ose të kolonës ose më tepër TAC ose RMN për të përjashtuar sëmundjet të papajtueshme me ndërhyrjen. Por vet shoqata e radiologeve dhe imazheristeve në disa vende të botës: se një vizite e kujdeshme me ane të analizave të përshtatshme janë të mjaftueshme pa iu nënshtruar këto rrezatimit të rrezikshëm dhe duhet të evitohen këto ekzaminime rutine. Dhe kur ka dhimbje të shpinës, beli ose ischialgi menjëherë pa u ndjekur – pacientit i rekomandohet skaner(TAC) ose Rezonance Magnetik (RMN) në kohën që kjo duhet bere në raste kur terapia me simptoma rezistence dhe kur terapia fizike dhe me ilaçe për të paktën për 6-jave pa efekt. Pra, edhe vete ju si pacient duhet të bëheni mjeku i vetes dhe te njihni “jo” mjekut në kohën e duhur, pasi duhet te sqaroheni mire dhe për efektet anësore qoftë të ekzaminimeve të ndryshme si dhe për ilaçet që merrni. Dhe gjithnjë duhet të bëni pyetjen nëse procedurat klinike “a janë efikase dhe të sigurta”? Realiteti qëndron krejt



dhe pastaj diskutohet me mjekun për të eliminuar shkaku dhe dhimbjes qofte me ilaçe ose duke përmirësuar mënyrën e jetesës ose duke qorruar qëndrimet e “keq” si qëndrimin para kompjuterit për kohe të gjate etj.

Ilaçet kundër “djegies se stomakut” urthit, gastritit. Shpesh përdoren për kohe të gjate, me muaj frenuesit e pompës sodike që bllokojnë prodhimin e acidit ne stomak. Në qoftë se ato merren shume gjate rrezikojnë për infeksion të zorrëve, të mushkërive dhe deri për fraktura kockore. Ato merren vetëm në rastin e ulcerave ose në rastin e rikthimit të acidit në ezofak (refluksi-gastro ezofageal) dhe në doza sa më të vogla që të jetë e mundur. Për çrregullimet e stomakut zakonisht mjafton që të merret bikarbonat, kripna të magnezit ose aluminit si alukol ose gaviskon, maloox si dhe duhet të keni kujdes me llojet e ushqimeve. Duhet te merrni masa për të përthypur mire ushqimet, të evitohen ngrehja e shpejt dhe të evitohen ushqimet që shtojnë aciditetin duke dhënë djegie si alkooli, kafeja, çokollata etj.

Përdorimi rutinë i antibiotikeve. Përdorimi i shpeshte dhe i pamotivuar si dhe pa atibiogramë ka bere të paefektshëm antibiotiket saqë në shumë raste të renda nuk mund të gjesh asnjë antibiotik

japin efekte anësore të padëshiruara si mukoza çrregullime në zorre si p.sh colit nga mbivendosja e chostridium –dificile mikrob i cili vjen si rrjedhojë e marrjes se antibiotikeve kryesisht e ceporinave. Pra, në asnjë mënyrë nuk duhet të përdoret si rutine antibiotike-terapia në grip apo infeksione të tjera virale dhe po ashtu as në pjesën më të madhe të sinusiteve. Ato janë prodhuar vetëm për infeksionet bakteriale dhe duhet patjetër të bëhet me përcaktimin e ndjeshmërisë së këtyre baktereve me antibiogramë të cilësuar për bakterin.

Përdorimi i somniferve. Midis ilaçeve më të përdorur futen benzo-diazepinat si valiumi, lorazepam etj. Por nevojitet te evitohet sot pasi ka metoda të tjera për të sjellë gjumë, përdorimi i zgjatur i tyre çon në ankth, irritim, në humbje të kujtesës të ngjashme me demencen, në halucinacione etj. Ilaçet “Z” si zolpidem, zoleplon, zopiklon janë alternativa shume me te sigurta sesa benzo-diazepinat valium Librium te cilat kane efekte anësore sic thame me lart. Për të pasur gjumë të mire kërkohet në radhe të pare të mos përdoren ilaçe, por të zbatohen disa rregulla të higjienës se gjumit si mos shtrirja për pushim pasdite dhe asnjëherë të mos përdoret shtrati për gjë tjetër vetëm për të fje-

ndryshe. Në mbi 2500 procedura të kryera me evidence të mira shkencore vetëm 46 % e tyre kane rezultuar të dobishme dhe 4 % janë gjykuar të rrezikshme si p. sh 50 % e angioplastikave (vendosja e stentit) të kryera në pacientet me angina pectoris të qëndrueshme janë vlerësuar si jo të sakta dhe vetëm pak mbi 50 % e kurave të marruar kane dhënë përmirësim. Po ashtu 80 % e ilaçeve të reja të hedhura në tregun farmaceutik janë kopje ose riprodhim i të vjetrave dhe vetëm 2.5 % e tyre kane një përparim terapeutik. Kështu p.sh: insulinat moderne nuk iu japin përfitime me te mëdha pacienteve përjashtuar mënyrën e re të injektimit me pene. Prandaj kërkoni mjekut cili është avantazhi, përparuesit e mjekimit të ri - krahasuar me te më parshmit. Sot po përshkruhen ilaçe dhe për të përballuar reaksionet normale të jetës si: në pleqëri, në fatkeqësi te ndryshme si: zia e vdekjes, humbja e punës „divorci”, trishtimi, mos suksesi ne jete, tërbimi ose melankolia, pesimizmi etj. Jo te gjitha duhet te konsiderohen njëllloj si “sëmundje” dhe duhet te përpiqemi te tejkalojmë trishtimin, preokupimin pa kërkuar ilaçe, te cilat çojnë ne mpirje “anestezia” të emocioneve, Pra, në asnjë rast nuk duhet te jeni ju iniciatorët që ti kërkoni mjekut një recete me ilaçe.

T'i ndeshnim sytë do herësh na pat shtye
ne ai lexim e faqet skuqë na i ka;
132 por veç n'një pikë t'tregimit jemi thye.⁴³
Kur bash lexuem si buzët ndezë sa s'ka,
u puthën nga dashnori zjarrpushtue,
135 njëky, që 'i herë prej meje nuk asht nda,⁴⁴
më puthi n'buzë i gjithi drithëruë.
Galeot libri u ba dhe kush e shkroi:
138 atë ditë e ma nuk mundëm me lexue».⁴⁵

vetëm qemë, s'mendonim për ligsi - A bahet fjalë këtu që ata nuk dyshonin se ndokush mund t'i zaje në flagrancë, apo se ata nuk e synonin atë që do të ndodhte mbas pak, ndërsa gjendeshin vetëm për vetëm?! Komentuesit e hershëm nuk janë në një mendje dhe enden mes këtyne dy interpretimeve. Por për komentuesit modernë duket krejt e sigurtë se bahet fjalë për rastin e dytë. Në fakt, kjo zbulohet nga vetë fjalët e Françeskës. Përgjigjia e dytë e saj ka lidhje me pyetjen e fundit të Dantes (v.120). Ajo rrëfen se nuk ka një fillesë ma të hershme të dashnisë së tyne, se sa ajo mbasditë. Ata nuk janë ulë me lexue për atë qëllim, sepse nuk e kishin idenë se ç'do të ndodhte mes Lançelotit dhe Guinevrës. Gjithçka ishte spontane. Të dy rrethanat, pra të qenit vetëm dhe të mos pasunit arsye me u riejtë prej ndokujt, janë vërtetë lehtësuese për fajin e Françeskës, sepse favorizojnë spontanisht atë çfarë mbas pak do të ndodhë. Ndryshe do të ishte sikur ata të linin takim: do të ruheshin dhe do të ishin ma shumë fajtorë, çka ma pak do të prekte mëshirën e Dantes dhe keqardhjen e lexuesit, madje do të thoshim se aspak nuk do të ishin në katalogun e personazheve të mrekullueshme danteske.

43 *T'i ndeshnim sytë* - Ndërsa lexonin skenat erotike, ndërsa përfytyronin personazhet të përvëlue nga dashnia, edhe se adultere, pashmangshëm kanë kqyrë përvjedhtas njeni-tjetrin, shikim që i ka ba të gjejnë situatën e tyne pasqyrë të asaj që po lexonin; shikim që i ka shkri në ambëlësinë e intimitetit të ndaluem... *Kryqëzimi i shikimeve dhe skuqja e faqeve* (ata ende nuk janë dashnorë) janë gozhdat e fuqishme ku varet kuadri i kësaj skene në murin e Kangës së Dashnorëve.

veç n'një pikë t'tregimit jemi thye - Ajo çfarë e ban Françeskën një nga personazhet ma të dashtuna danteske, asht vetëdija e saj për fajin adulter. Folja *thye* tregon betejën e humbun përballë tundimit, rrëfyë ma sipër me dy folje të tjera: *kryqëzue* (sytë) dhe *përflakë*. Ajo e din se bahet fjalë për një betejë të humbun (mëkatit), aspak për një fitore (siç në fakt asht një dashni e drejtë) me të cilën krenohesh.

44 *u puthën... zjarrpushtue* - Në romanin e Lançelotit, asht Xhinevra që puthë atë, nxitë prej maxhordomit të saj, Galeotit. Në histori të tilla, puthja ishte vula e dukshme dhe e pakthyeshme e dashnisë, dhanë prej damës ka-valorit të saj, në prani të dëshmitarëve. Gjurmë të këtij gjesti kanë mbetë në puthjen e çifit që sapomartohen, në prani të atynë që asistojnë në ceremoni. Në skenën e përshkrue në librin që po lexonte Françeska e Paolo, dëshmitari në atë vulosje dashnie adultere asht Galeoti. Dante e ka ndryshue paksa skenën: për të asht Lançeloti që puth Guinevrën. Pse vallë?! Për ta përshtatë me atë të Françeskës?! Po kush e di çfarë ka ndodhë në atë dhomë, kur ata kanë qenë vetëm për vetëm: e ka puthë Françeska Paolon së pari, apo Paolo Françeskën?! Në vulosjen e dashnisë së tyne, askush nuk ka qenë dëshmitar, përveç librit, që u ba *Galeot... Kështu, Dante, për arsytet që vetëm ai i di, riplazmon të gjithë historinë, e cila kulmon me atë puthje, fshehun syve dëshmitarë, të cilën ai e hamendëson me anë të forcës së fantazisë së tij krijuese.*

njëky... nuk asht nda - Nga çasti i puthjes, Paolo nuk asht nda ma kurr nga Françeska... sepse mbas asaj puthje ka ardhë vdekja. Pandashmënia e tyne pafund, zgjatja e atij çasti magjik, për ta asht mpiksje në aktin i cili përcaktoi fatin e tyne në përjetësi. Thuese të gjithë të dënuemit e tij, Dante i fikson në çastin e mëkatit të tyne, në çastin ma dramatik për ta, në atë çast që përcakton dënimin...

45 *i gjithi drithëruë* - Figura e gjallë dhe konkrete e Paolos ndërsa dridhet, së bashku me sytë që kryqëzohen dhe të kuqët e faqeve (v.130-131), i shndërojnë ata në shembull të gjallë të pasionit të dashnisë. Kështu Dante, me një hap të madh, tejkalon poezinë dashnore të kohës së tij, madje edhe atë antike, tue i ofruë lexuesit një tjetër mjet gjuhësor (realizmin e zhveshun

E n'sa një shpirt së foluni mbaroi,
ai tjetri qante; e unë, nga mshira mekun,
141 u fika krejt dhe trupi plumb m'randoi.
E n'tokë kam ra, siç bjen një trup i vdekun.⁴⁶

Fjalor shpjegues Këngës V

NË TEKST

- dhunisht** V, v.67 "në mënyrë të dhunshme", formim nga emri *dhun/ë* me prap. *-isht*.
- hesht,-i** V, v.28 "heshti-a", emër abstrakt, neologjizëm i autorit.
- kurreshti,-a** V, v.125 "kurreshtja".
- pervers~e** V, v.93 "e pahijshme; e jashtëmoralshme; i mbrapshtë", huazim nga ital. *perverso* me të njëjtin kuptim.
- pshtjellue (me u)** V, v.6 "pëshjtjellohem; këtu: mbështillem".
- përleshë (i, e)** V, v.50 "që është e ngatërruar (si leshi); (e) përleshur; *fig. munduar*".
- reshtë (me)** V, v.30 "mbaroj; përfundoj; fashit".
- sish / asish /** V, v.52 "*(rasa rrjedhore e përemrit)* prej sish / asish".
- shorti,-a** V, v.37 "fati, shorti", formim nga *short* me prap. *-i*, neologjizëm i autorit.
- volitë (i)** V, v.45 "i volitshëm; që është më i pështatshëm për të bërë diçka, që mund të bëhet a përdoret më lehtë"; neologjizëm i autorit.
- zjarrpushtue** V, v.134 "që është pushtuar nga zjarri: këtu:

nga patetizmi kalorsiak e kortezial), ma të drejtpërdrejt, që asht ma afër tij, pa e humbë aspak magjinë e poezisë.

Galeot libri u ba - Rolin e Galeotit, ndërmjetësit dhe dëshmitarit mes Françeskës dhe Paolos, e luen libri që po lexojnë, a ma mirë të thuesh autori që ka përshkrue atë dashni të zjarrtë, e cila bahet shkëndia që ndez dashninë e Françeskës dhe Paolos.

atë ditë e ma nuk mundëm me lexue - Shumica e komentuesve mendon se vrasja e tyne ban të pamundun leximin e mandejtë. Të tjerë mendojnë se, atë ditë e ma, të rrinin bashkë, nuk kishin nevojë për librin. Por ky version i dytë asht tepër i bukur për t'u marrë si i vërtetë e, po të ishte kështu, dramaciteti a tragjizmi i kësaj historie nuk do të ishte në nivelin e mjaftueshëm për t'u thirrë në këtë kangë dashnorësh të pafat.

46 *tjetri qante* - Vajtimi i Paolos ka shoqnie rrëfimin e Françeskës, si të ishte sfondi muzikor i një pjese funebër, tue e ba ma dramatik rrëfimin, por që asht tregues, në të njëjtën kohë, i përfshimjes së tij totale në këtë histori dashnie adultere, tragjike dhe të dhimbshme. Asht ky vajtim i heshtun i njeriut të vetëdijshëm për fajin, por në të njëjtën kohë i rezervuem në fjalë, që prek deri në thellësinë e shpirtit Danten ndërsa dëgjon këtë histori. Mëshira, të cilën e ka deklarue ma herët (v.72 dhe 93), madje përmes lotëve, këtu e përmbyt, tue e ba me humbë ndjenjat.

nga mshira mekun - Kuptimi i një mekjeje a të fikti të tillë asht ma i thellë se mund të mendohet. Ai duhet gjurmue në të gjithë rrjedhën e kësaj historie, e jo thjeshtue në nivelin e një përmalljeje ndaj një ngjarjeje tragjike. Ky nuk asht rasti i vetëm në këtë Kantik ku Dante humb ndjenjat, siç e kemi pa (K.III, v.135). Mëshira që ai ndjen përgjithësisht për gjininë njerëzore, asht vula e dallueshme e këtij rrëfimi, në të cilin ai përfshin tanësisht, jo vetëm meditimim e gjatë etik, por edhe eksperiencën personale në njohjen e gjendjes së njeriut, themel mbi të cilin ndërtohet e gjithë *Komedia*. Ai sheh vetveten tek Françeska, siç asht e kuptueshme, por edhe ma ndej: sheh gjininë njerëzore, me gjithë dinjitetin dhe bukurinë, që vetëdijshëm shkon drejt humbjes. Kjo asht mëshira reale e konkrete që e përshkon gjithë Ferrin e Dantes.

pushtuar nga zjarri i dashurisë", kompozitë e formuar nga *zjarr + pushtue*", neologjizëm i autorit.

NË SHËNIME

- adulter~e** V, sh.24 "/ai/ajo/ që shkaktonte shkelje të besnikërisë bashkëshortore", huazim nga ital. *adultero* po me të njëjtin kuptim.
- arturian~e** V, sh.23 "që i përkasin së mbretit Artur (kohë, hero, roman)".
- asir** V, sh.18 "që i përkasin asirëve, banorët e Asirisë së lashtë të antikitetit".
- atribue (me)** V, sh.18 "jap, caktoj, njoh (një cilësi të dikujt)", huazim nga ital. *attribuire* me të njëjtin kuptim.
- avanc/ë,-a** V, sh.26 "guxim (dashuror) në sjellje të një burri ndaj një gruaje".
- barrier/ë,-a** V, sh.34 "pengesë", huazim nga italishtja *barriera* me të njëjtin kuptim.
- besëpremj/e,-a** V, sh.23 "të pririt në besë", kompozitë e ndërtuar nga *bes/ë/ + premje*, neologjizëm i autorit.
- brendapërfshi (me)** V, sh.29 "përfshij brenda"; kompozitë e ndërtuar nga *brenda + përfshi*, neologjizëm i autorit.
- ciklonik~e** V, sh.10 "që është si cikloni; vorbulluese; pëshjtjelluese".
- demoniak,-u** V, sh.6 "me përdorim si biem. *diallëzor* dhe si emër *demon* "djall".
- destinue (me u)** V, sh.37 "i nënshterohem një fati të caktuar".
- fatalisht** V, sh.35 "në mënyrë fatale; në mënyrë të pashmangshme", përdoret gjithmonë në kuptimin e keq - që sjell vdekjen.
- fines/ë-a** V, sh.29 "mirësjellje; delikatesë", huazim nga ital. *finizza* me të njëjtin kuptim.
- fisnikëror~e** V, sh.24 "në mënyrë fisnike".
- homerian~e** V, sh.22 "që i përkasin Homerit; që i përkasin asaj kohë, asaj lloj letërsie".
- homerik** V, sh.2 "që i përkasin Homerit; që i përkasin asaj kohë, asaj lloj letërsie".
- intuitivisht** V, sh.25 "në mënyrë intuitive".
- ironikisht** V, sh.18 "në mënyrë ironike".
- kalorsiak~e** V, sh.23 "sjellje fisnike, oborrtare".
- kompensim,-i** V, sh.25 "shpagë; shpërblim; përfundim i veprimit të foljes *kompensoj*".
- komplikuem (i, e)** V, sh.23 "i ngatërruar; i vështirë për t'u zgjidhur".
- konfidenc/ë,-a** V, sh.27 "mirëbesim", huazim nga italishtja *confidenza* me të njëjtin kuptim.
- konfirmue (me u)** V, sh.3 "me u pranue vërtetësisht".
- konsoliduem (i)** V, sh.1 "i qëndrueshëm; që ka marrë trajtë përfundimisht".
- kushdogjendë** V, sh.3 "kushdo që gjendet para".
- lumní-a** V, v.3 "lumturia; këtu: të qenit në Parajsë".
- mbikqyrun (i)** V, sh.3 "/ai/ që është nën vëzhgim".
- mitmarrij/e,-a** V, sh.5 "ryshfet".
- mitmarrës,-e** V, sh.5 "ai, ajo që merr ryshfet".
- opus,-i** V, sh.34 "vepra e plotë e një shkrimtari etj."
- padëshiruem (i)** V, sh.2 "/ai/ që nuk është i pranuar (në një rreth, ambient)".
- pakthim (i)** V, sh.4 "që nuk kthehet; këtu: që nuk ndryshon, as lehtësohet kurr", fomuar nga *kthim* me parashtesën *pa-*, neologjizëm, krijim i autorit.
- pambajtshëm~e** V, v.113 "në mënyrë të pambajtshme; që nuk mund të ndalet"; përdorim ndajfoljor, neologjizëm i autorit.
- pandashmëni,-a** V, sh.44 "të qenurit i pandashëm", formuar nga *ndashmëni* me parashtesën *pa-*, neologjizëm i krijuar nga autori.
- pangatrrueshme** V, sh.13 "që nuk mund të ngatërrohet me diçka (dikë) tjetër; që dallohet".
- papërsëritshmëni,-a** V, sh.13 "të qenurit i papërsëritshëm", formim nga *përsëritshmëni* me parashtesën *pa-*, neologjizëm i krijuar nga autori.
- prokurator,-i** V, sh.26 "/ai/ që bën prokurë; /ai/ që kryen një punë/shërbim në këmbë të një tjetri, si të ishte ky vetë".
- përmallisht** V, sh.16 "përmalluar; në mënyrë të përmallshme", formuar nga *përmall* me prap. *-isht*, neologjizëm i krijuar nga autori.
- ridërgue (me u)** V, sh.23 "dërgoj për së dyti", formim nga *dërgue* me parashtesën *ri-*, neologjizëm i autorit.
- riplazmue (me)** V, sh.44 "plazmoj për së dyti; formoj, krijoj përsëri".
- saporrrëfyem (i)** V, sh.4 "që është rrëfyer në atë kohë".
- tonue (me u)** V, sh.43 "këtu: dallohem; theksohem".
- trinar** V, sh.3 "që përfaqëson tri pjesë; që përbëhet nga tri pjesë".
- vetëkuptue (me)** V, sh.1 "vetëkuptoj, pa patur nevojë për shpjegim; këtu: sugjeron".
- vizualisht** V, sh.10 "në mënyrë të dukshme; që shihet me sy".
- vërtetësisht** V, sh.3 "në mënyrë të vërtetë".

(Kanga VI vijon në numrin e ardhshëm)



VLLAZNIA PERFUNDOJ NË FERRIN E MERITUAR

MË MIRË NJË FUND I TMERRSHËM SE NJË TMERR PA FUND!

“Liburna” jone e zemrës prej vitesh kishte marrë një udhë pa kthim, prandaj përfundimi i saj në Ferr nuk është katastrofë, as tragjedi aksidentale por një fundosje gradualë në sy të gjithëve.

Të këndosh për historinë motit shkuar të udhëtosh pa busull me stilin e vjetër socialist në detin e llahtarshëm të futbollit borgjez është aventurë Donkishoteske.

Tash më kopeja që gabimisht mban në qafe trokën e “Vllazni” shkoj të kullojë në ograjën që meriton.

Nuk ka vend më as për vajtime qyqane, as për rrufe shpaguese.

Kush që do futbollin shkodranë dhe i

gjashna në dorë, ndonjëse thuhet gjithë andej se ka qenë një nga ekipet më të mira paguara të kategorisë së elitare.

Mëkati më i madh i Bashkisë është se asnjëherë nuk duhet ta marrte Vllazninë si lopë Kryegjeje. “E grazhdisi bujarisht me tagji dhe koncentre” dhe nuk mori as gjë prej saj veç bajgat. Ku shkuan paratë kujtohem i pyesim tani pas 7 vitesh me habi si majmuni me habi ç’u bë sheqeri që u shkri në gotën e ujtë?

Futbolli është biznes dhe biznesit duhet t’i përkasë.

Dështimi futbollit tashmë në djep thyer në Shkodër është vepër e ligë e biznesmenëve bark te mëdhenj e zemër vegjël

qoftë si nuk e morët për dorë të loçkën Vllazni por e latë me katër rrugëve si vejushë të mjere e pa përkrahje.

Vllazninë Zonjë në demokraci bënë tervesë mëdhenjtë Myftar Çela dhe Valter Fusha të cilët me “çuditërisht” as njeri nuk ishin shkodranë të vjetër: Madje fatkeqësisht dhe vetëm për këtë fakt pati jo pak xhelozia të shoqëruar edhe me gur nën rrota.

Nga Vdekja e njërit dhe divorci i tjetrit përfundimisht Shkodra mbeti jetimë pa as një trofe por çfarë është dhe më dramatike edhe “Vllazni”.

Mjerisht futbollit ka degjeneruar në bixhos të piste ku futë duar deri në berry-

në këto tre javët e fundit.

Vllaznia shkoj drejt vdekjes në mënyrën më të shëmtuar, pa pike dinjiteti e qyrravitur, brekëlagur, duke qarë me lot e puthur këmbët e kampionëve, nën kampionëve, e laçiave që u treguan bujarë më shkodranë kuqebluhtë tanë të mjerë.

E keqja ndodhi por ajo mund të thellohet nëse nuk merren masa konkret urgjente dhe nuk nxirren mësimet.

Po nuk u privatizua Klubi ka rrezik që “Vllaznia” të endet në inferiore si çifuti në shkretirë duke mos gjetur dot rugën e rikthimit në mesin e parikve ku duhet të jetë.

Çdo keq ka një të mirë. Rrëzimi 2018



Vllaznia, fituese e Kupës së Republikës, në vitin 1981

thërret logjikës se kthjelltë me plot gojën ka të drejtë vikasë.

Kujt i duhet një Vllazni zvarranike pa gjak me brekë nëpër këmbë një rriqën llupëse në shpinën e kockë e lëkurë të taksapaguesve të qytetit tonë?

Kujt i duhet një Vllazni zhelamane si qerre pa buaj në mëshirë të klluçit?

Kujt i duhet një “Vllazni” e gjithkujt dhe askujt e drejtuar nga një stan bataqish?

-Bashkisë se Voltanës i mbeti dopjo

të Shkodër Loces .

. Po qe shkodranë i bën të gjitha !

Sot pas këtij klisi mburravec nuk mund bilbilojë askush, përderisa Vllaznia e futbollit përfundoj në greminë dhe askush nuk e zgjati dorën për ta shpëtuar.

Ju shkodranë koprrac të botës së biznesit si latë të shembet e të bjerë në baltë bazilikën e vjetër pa të cilën ky qytet do thirrej e do thirret Shkodra e shkkjeptë (e çalë)

Zotni të vjetër e borgjez te ri haram u

laedhe politika duke na sërviur shfaqe teatrale banale siç qenë dhuratat banale, të Kukësit, Korçës Laçit, por edhe në karhun tjetër te Partizanit. Vllaznia ra që në ndeshjen me Kamzën duke falimentuar në shtëpinë më saj më të mirën e më komoden që ka ky vend i çuditës me emrin Shqipëri.

Duke revokuar madhështinë dikurshme të “Romës së vjetër”(Vllaznisë), e din një zot se çfarë u luajt në prapaskenë, por vetëm futboll jo sidomos

i Vllaznisë është një njollë e zeze e dyta për nga madhësia në historinë e lavdishme të këtij ekipi lavdiplotë, ajo që u bë nuk ç’behet më.

Vllaznia duhet ringritur drejt majave urgjentisht prandaj më mirë një fund i tmerrshëm se një ferr pa fund.

Prelë Milani

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

